



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

NR
DT 10.10 2021
PROY

Nr. 11541/Prist
4

Tiranë, më 3/10/2025

LËNDA: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

Z. Andi KANANAJ
DREJTOR EKZEKUTIV

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

TIRANË

Në përfundim të auditimit të kryer në Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, po j'u dërgojmë raportin përfundimtar të auditimit së bashku me planin e veprimit.

Bazuar në nenin 12, gërma d, të Ligjit 114 datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, pikës 3 të urdhrit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 13.02.2017 "Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm", brenda 30 ditësh, duhet të hartoni dhe miratoni planin e veprimit për zbatim e rekomandimeve dhe të njoftoni drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu mirëpresim opinionin tuaj, lidhur me punën tonë duke plotësuar formularin e vlerësimit, i cili do të na shërbente për të vlerësuar performancën tonë dhe për të identifikuar fushat ku duhet të përmirësohemi për të qenë të dobishëm për ju dhe të tjerët.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT PËRFUNDIMTARË AUDITIMI

NJËSIA E AUDITUAR

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

NJËSIA E AUDITUESE

DREJTORIA AUDITIMIT NË MFE

LLOJI I AUDITIMIT

**AUDITIMI I SISTEMEVE, PËRPUTHSHMËRISË,
FINANCIAR & ZBATIM REKOMANDIMESH**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në zbatim të ligjit nr. 114, datë 06.11.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, marrëveshjen e bashkëpunimit nr.10197/3 datë 23.06.2023, "Për kryerjen e shërbimit të të auditimit në AMSHC" dhe planit të auditimit nr. 11541/1, datë 14.08.2025, në Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është kryer një mision auditimi "Për auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, përputhshmërisë dhe financiar".

Në përfundim të misionit ka rezultuar:

- Aktualisht, marrëdhëniet e punës së stafit të AMSHC-së janë të rregulluara me ligjin "Për shërbimin Civil" për shumicën e stafit dhe për një pjesë rregullohen me Kodin e Punës. Referuar ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e AMSHC-së" dhe statutit është përcaktuar se marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës. Sipas strukturës në fuqi janë të plotësuara të gjitha pozicionet e punës si dhe janë të punësuar dhe 2 punonjës me kontratë të përkohshme të miratuar me VKM.
- Në vitin 2023 për thirrjen nr. 16 janë shpallur fitues 64 projekt propozime ose 45.4% dhe janë skualifikuar 77 kandidatë (nga 141 pjesmarrës), prej të cilëve 41 projekt propozime për mungesa në dokumentacion, në vitin 2024 për thirrjen nr. 17 janë shpallur fitues 73 projekt propozime ose 48.3% dhe janë skualifikuar 78 kandidatë (nga 151 pjesmarrës), prej të cilëve 40 projekt propozime për mungesa në dokumentacion dhe në vitin 2025 për thirrjen nr. 18 janë shpallur fitues 76 projekt propozime ose 47.5% dhe janë skualifikuar 84 kandidatë (nga 160 pjesmarrës) prej të cilëve 60 projekt propozime për mungesa në dokumentacion.

- Ka raste ku vlera e projektit të propozuar kishte buxhet më të madh se buxheti i akorduar nga AMSHC dhe në këto raste subjekti ka deklaruar se do ti mbulojë vetë diferencën e burimeve për financimin e plotë të projektit.
- Janë përgatitur raportet narrative për monitorimin e zbatimit të projekteve përfituese dhe janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit financiar, sipas rregullave.
- Për periudhën 6-M II 2023, 2024 dhe 7-M 2025, institucioni ka përfutur fonde nga buxheti i shtetit për shpenzime korente, grande dhe investime kapitale.
- Detajimi i buxhetit dhe ndryshimet në buxhet janë bërë në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". Janë mbajtur akt-rakordimet për shpenzimet, të cilat kanë disa problematika për sa i përket plan buxhetit dhe plan thesarit, si dhe janë përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Procedurat mbi zbatimin e kriterëve për detajimin, rialokimin dhe transferimin e fondeve buxhetore janë bërë në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Realizimi i buxhetit për vitin 2023 ka qenë në masën 99 %, për vitin 2024 në masën 98% dhe për 7 mujorin 2025 realizimi i shpenzimeve ka qenë në masën 44% e llogaritur kjo mbi planin vjetor. Për vitin 2025 realizimi i buxhetit është në proces. Në dinamikë, fondet buxhetore vjetore të planifikuara kanë patur trend rritës.
- Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore në vitet 2023 dhe 2024 janë realizuar në masën 99%, ndërsa për periudhën 7 mujore të vitit 2025 në masën 57% e planit vjetor të miratuar. Llogaritja e pagës për çdo punonjës është bërë në përputhje me aktet ligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e pagave. Përmbledhësja e pagave rakordon me pagesat e bankës.
- Për një rast nuk janë reflektuar ndryshimet në pagë, sipas vkm nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", ku pika 9 e vkm-së ka ndryshuar nivelin e shtesës për pagesë për çdo nivel shkalle vështirësie (për punonjësën e magazinës).
- Kategoria e pagave sipas VKM-së nr. 157/2016 me të cilën është miratuar dhe struktura e AMSHC-së duhet të përshtatet si kategori me ndryshimet përkatëse në nivelin referues aktual të kategorive të pagave sipas VKM-së nr. 325/2023 e ndryshuar.
- Llogaritja e kontributeve për sigurime shoqërore, shëndetësore dhe TAP, si dhe derdhja e tyre në favor të tatimeve është bërë në përputhje me ligjin nr. 9136 datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSh", i ndryshuar, dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 16.04.2009.
- Shpenzimet faktike në Art.602 "Shpenzime operative", gjatë vitit 2024 rezultun 18% më ulët se shpenzimet faktike të vitit 2023. Nga 5,849 mijë lekë të shpenzuara në vitin 2023, gjatë vitit 2024 janë shpenzuar 4,780 mijë lekë ose 1,069 mijë lekë më pak. Rregjistrat e parashikimit, për periudhën nën auditim janë dërguar jashtë afatit përcaktuar në VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
- Një prej punonjësve me kontratë të përkohshme, me emërtimin "Specialist" ka marrë ndihmë të menjëhershme financiare në shumën 15,000 lekë, jo në përputhje me pikën 1 të VKM-së, nr.846 datë 26.12.2024.
- Shpenzimet për investimet (Art.231), gjatë viteve 2023 dhe 2024 kanë rënë krahasuar periudhat e mëparshme, duke rezultuar me një realizim poshtë nivelit 50% kundrejt planit të miratuar për investimet, përkatësisht 49% dhe 46%. Gjatë 7-mujorit 2025 nuk ka patur realizim të investimeve.
- Në Akt-Rakordimet me degën e Thesarit për sa i përket shpenzimeve për periudhën e auditimit, u konstatuan gabime në plotësimin e tyre për periudhën nën auditim.

- Veprimet kontabile janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumentave justifikuese dhe janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.
- Nga shqyrtimi i rezultateve për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezultoi se nga 5 rekomandie të lëna, janë realizuar plotësisht 4 rekomandime dhe është në proces zbatimi 1 rekomandim.

IIYRJE

Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile është ent publik qendror, buxhetor i rregulluar me ligjin nr. 10093/2009, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile" dhe me VKM nr. 769 datë 15.07.2009 "Për Miratimin e Statusit të AMSHC-së", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore.

Objekti i veprimtarisë së saj është ofrimi i asistencës financiare për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, si dhe programe të tjera, duke krijuar kushte të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut, duke i përshtatur me përparësi strategjitë e programit qeveritar sipas fushave.

Fushat e auditimit sipas parashikimit në Planin e auditimit janë; auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, auditimi i përputhshmërisë dhe auditimi financiar.

Objektivi i auditimit është: Të arrijë të japë siguri objektive për institucionin se objektivat e caktuara prej tij nuk rrezikohen që të mos realizohen nga niveli i riskut dhe menaxhimit të tij, dhe se veprimtaria është në përputhje me ligjet dhe udhëzimet që rregullojnë veprimtarinë e saj.

Auditimi është zhvilluar në përputhje me ligjin 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", manualin e auditimit të brendshëm, si dhe standartet ndërkombëtare të pranura në fushën e auditimit të brendshëm të sektorit publik.

Auditimi u përqëndrua në vlerësimin e zbatimit të rregullave të brendshme dhe të jashtme që rregullojnë veprimtarinë e AMSHC-së, mbarëvajtjen e proceseve të veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe pagave, zbatimin e rregullave për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën nën auditim si dhe zbatimin e procedurave në ofrimi i asistencës financiare.

TERMAT E AUDITIMIT

Auditimi është kryer në zbatim të nenit 14 të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brëndshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar dhe në Aktmarrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 10197/3 datë 23.06.2023 "Për kryerjen e shërbimit të auditimit në AMSHC", si dhe Planit të Auditimit nr. 11541/1, datë 14.08.2025.

Auditimi është kryer nga Rregjina Mikeli, përgjegjës grupi dhe Agim Paskali, anëtar.

Periudha e auditimit është 01.07.2023 - 31.07.2025. Afati për kryerjen e auditimit është 18.08.2025 deri në 05.09.2025.

Në zbatim të Manualit të Auditimit, është njoftuar subjekti me shkresën nr. 11541 datë 31.07.2025 dhe është mbajtur takimi prezantues me drejtuesin e institucionit, ku janë paraqitur objektivat dhe plani i auditimit.

Në përfundim të punës në terren dhe gjatë auditimit, u diskutuan gjetjet e auditimit me drejtuesin e institucionit dhe stafin. Me shkresën nr. 114541/2 datë 19.09.2025, subjektit i është përcjellë Projekt Raporti i Auditimit me rekomandimet e sygjera, të cilin e ka kthyer pa kundërshtime me shkresën nr.1154/3 datë 29.09.2025. Më poshtë po paraqesim Raportin Përfundimtar të Auditimit.

METODAT E PËRDORURA

Për realizimin e auditimit u përdorën metodat dhe teknika auditimi në varësi të fushës së audituar si; metoda e intervistimit, e leximit dhe studimit të raporteve, krahasimit dhe modelimit statistikor, pyetorët, etj. Gjithashtu janë përdorur teknika të përzgjedhjes dhe ekzaminimit të transaksioneve në grup dhe pjesore, si dhe metoda e vlerësimit të transaksioneve dhe llogaritjes analitike për shpenzimet e kryera për periudhën nën auditim dhe për inspektimet e kryera sipas muajve të përzgjedhur.

BAZA LIGJORE

Baza ligjore

- Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funkionimin e Agjencisë për Mbrojtjen e Shqiptarëve Civilë".
- Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbrojtjen e Shqiptarëve Civilë", i ndryshuar.
- Rregullorja e brendshme
- Rregullorja "Mbi procedurat e Financimit me Grant në Mbrojtje të Shqiptarëve Civilë", e ndryshuar
- Udhëzim nr. 1 datë 10.06.2014 "Për plotësimin e raporteve financiare dhe kontrollin financiar, për efekt monitorimi të Projekteve të financuara me Grant nga Agjencia e Mbrojtjes së Shqiptarëve Civilë"
- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.
- Ligji i buxhetit të RSH.
- Udhëzim i MF nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"
- Udhëzim i MF nr. 31 datë 31.12.2024 "Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e propit të menaxhimit të risqeve në sektorin publik"
- Udhëzim nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar me udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare";
- Udhëzim nr. 159, datë 18.10.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 311, datë 23.12.2020 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të cilësive të KB në NJQP"
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave, nr. 2, datë 26.1.2024, "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike";
- Manuali i MFK-së miratuar me urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024
- Ligji "Për arkivat" nr. 9154 datë 16.11.2003, i ndryshuar.
- Normat Teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH.
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar
- Udhëzimin nr. 1, datë 03.06.2025 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 "Për Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar
- Udhëzimi nr. 30/2011 i ndryshuar "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".
- Ligji nr. 25, datë 10.05.2018 "Për korrabilitetin dhe pasqyrat financiare"
- Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"
- Prj

GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO FUSHË

Në këtë projekt raport po paraqesim gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të auditimit pas përfundimit të misionit të auditimit në fushën e veprimtarisë së AMSHC-së, për periudhën e audituar, sa vijon:

GJETJET SIPAS FUSHAVE

I. AUDITIMI I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM.

Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për pesë komponentët (mjedisi i kontrollit, aktivitetit i kontrollit, vlerësimi i rrisht, komunikimi dhe monitorimi).

MASA NR 1	
LIDHJA ME PROGRAMIN E AUDITIMIT	I. AUDITIMI I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM.
GJETJA	- Për AMSHC-në, aktualisht, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, procedurat e emërimit/apo largimit të stafit, si dhe niveli i pagës së tyre realizohen në zbatim të ligjit "Për shërbimin Civil" dhe aktet nënligjore të tij (me përjashtim sekretares dhe sekretariatit e KKSHC, që punësohen me kodin e punës), pavarësisht se në ligjin 10093/2009 dhe në Statut është e përcaktuar që marrëdhëniet e punës së stafit rregullohen me Kodin e Punës, e konkretisht: - Aktualisht sipas strukturës në fuqi janë të plotësuara të gjitha pozicionet e punës si dhe janë të punësuar dhe 2 punonjës shërbimesh me kontratë të përkohshme të miratuar me VKM.
PËRSKRIMI I GJETJES	Mjedisi i kontrollit Fusha e veprimtarisë së këtij institucioni është e rregulluar me ligjin nr. 10093/2009, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile" dhe me VKM nr. 769 datë 15.07.2009, "Për Miratimin e Statusit të AMSHC-së", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore. AMSHC-ja është ent publik qendror, buxhetor dhe vepron për përmbushjen e misionit dhe të objektivave të saj, në përputhje me ligjin 10093, datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë fusha të veçanta të veprimtarisë. Misioni i AMSHC është ofrimi i asistencës financiare për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, si dhe programe të tjera, duke krijuar kushte të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut. Integriteti personal dhe etika profesionale e punonjësve, është e rregulluar me Kodin e Etikës, të miratuar me ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003.

"Rregulla të Etikës në Administratën Publike" dhe kodin e Etikës së institucionit të miratuar me urdhërin nr. 63 datë 12.02.2020 të Drejtorit Ekzekutiv. Nuk u raportuan raste të konstatuara për shkelje të etikës nga stafi.

Përsa i përket strukturës organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkisë etj, rezultoi se:

Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të AMSHC-së është e përcaktuar në ligjin nr. 10093/2009 dhe Statutin e saj.

AMSHC drejtohet nga:

- a) Bordi Mbikëqyrës i cili përbëhet nga 9 anëtarë
- b) Drejtori Ekzekutiv i cili emërohet/shkarkohet nga bordi

Struktura e administratës përcaktohet në Statut, **ndërsa numri i punonjësve të AMSHC-së miratohet nga Këshilli i Ministrave**, si zë më vete, në përputhje me ligjin për buxhetin vjetor.

Struktura është miratuar që me krijimin e institucionit me VKM nr.769, datë 15.07.2009, "Për Miratimin e Statusit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", ku në Statut është përfshirë dhe struktura e AMSHC me 13 veta në total. Kjo strukturë është ndryshuar me VKM nr. 157 datë 02.03.2016, me të cilën janë miratuar ndryshimet në statut dhe në strukturë ku numri gjithësej i punonjësëve nga 13 veta është bërë 16 veta.

Aktualisht Organizimi i strukturës është sa vijon: **(16 punonjës)**

Drejtor Ekzekutiv - 1

- Sekretar - 1

- a) Sektori i Administrimit të Programeve të Granteve dhe Zhvillimit Rajonal (1 + 2)
- b) Sektori i Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit (1 + 3)
- c) Sektori i Financës dhe Kontrollit të Brendshëm (1 +3)
- d) Njësia për Sekretariatën e KASHC-së e përbërë me 3 specialistë.

Organizimi dhe funksionimi i stafit rregullohet me Rregulloren e brendëshme të miratuar nga Bordi nr. 3 datë 01.12.2017 dhe sipas sektorëve funksionet kryesore të tyre janë:

e) *Sektori i Administrimit të Programeve të Granteve dhe Zhvillimit Rajonal*, është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe koordinimin e dhënies së granteve strategjike, të zhvillimit rajonal, të zhvillimit të shoqërisë civile, si dhe të filantropisë e të komunitetit. Në procesin e implementimit të projekteve fituese (integrimi, korrupsioni, transparencë, edukimi etj. përsa u përket granteve strategjike) përgatit informacione për ecurinë e projekteve fituese, për palët e interesuara. Identifikon nevojat strategjike të komuniteteve të caktuara të cilat përfitojnë shërbime ose jo, përmes grupeve të shoqërisë civile dhe më pas bën hartimin e një programi specifik për zhvillimin e OJF-ve rajonale, etj.

f) *Sektori i Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit*, është përgjegjës për mbarëvajtjen e zhvillimit të projekteve, krijimin e bashkëpunimit dhe komunikimit të frytshëm me

partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për përthithjen e fondeve/donacioneve vëndase dhe të huaja, publike dhe private që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Shqipërisë.

g) *Spektori i Finances dhe Kontrollit të Brendshëm*, është përgjegjës për: planifikimin buxhetor për vitin fiskal, detajimin e raportit vjetor të monitorimit për OJF-të përfituese të granteve; për mbarëvajtjen dhe monitorimin financiar të granteve që u jepen projekteve fituese, për ndjekjen e shpenzimeve financiare të kryera nga subjektet fituese sipas rregullave në fuqi, për verifikimet, për shpenzimet që kryen Agjencia për nevojat e administratës së saj dhe për menaxhimin e burimeve njerzore të institucionit.

h) *Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Shogërinë Civile*, është strukturë brenda AMSHC-së e cila luan rolin e sekretariatit teknik të KKSHC-së nga ana logjistike, mbajtjen e takimeve, arkivimin dhe komunikim, draftimin dhe përgatitjen e materialeve, koordinon punën në lidhje me marrëdhëniet e krijuara me aktorët e jashtëm, etj. AMSHC-ja kryen vetëm funksione ndihmëse dhe administrative për KKSHC-në duke mbuluar shpenzimet, në lidhje me veprimtarinë e KKSHC-së, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Për AMSHC-në, aktualisht, politikat dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerzore, procedurat e emërimit/apo largimit të stafit, si dhe niveli i pagës së tyre realizohen në zbatim të ligjit "Për shërbimin Civil" dhe aktet nënligjore të tij (me përjashtim sekretares dhe sekretariatit e KKSHC, që punësohen me kodin e punës), ndërsa në ligjin nr. 10093/2009 dhe në Statut është e përcaktuar që marrëdhëniet e punës së stafit rregullohen me Kodin e Punës.

Sa më lart rezultoi se Struktura e agjencisë miratohet nga bordi ndërsa numri i punonjësve dhe nivelet e pagave miratohen nga Këshilli i Ministrave.

AMSHC, aktualisht zbaton ligjin "Për Shërbimin Civil" dhe aktet në zbatim të tij. Në statutin e AMSHC-së përcaktohet se marrëdhëniet e punës rregullohen me kodin e punës. Akoma nuk është bërë një harmonizim i akteve të mesiperme në lidhje sa trajtuar pavarësisht përpjekjeve nga institucioni. Aktualisht në kuadrin e ndryshimit të ligjit për administratën publike, do të jetë e nevojshme më pas të kryhen ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore nga institucionet të cilat ligjet aktuale do të bien ndesh me këte ligj.

Aktualisht sipas strukturës në fuqi janë të plotësuar të gjitha pozicionet e punës si dhe janë të punësuar dhe 2 punonjës shërbimesh me kontratë të përkohshme të miratuar me VKM.

Politikat e menaxhimit të burimeve njerzore të drejtorisë, si procedurat e emërimit/apo largimit të stafit të drejtorisë, niveli i pagës së tyre, etj. janë të rregulluara me ligjin "Për shërbimin civil" dhe aktet në zbatim të tij si dhe me Kodin e Punës në RSH për një pjesë të stafit. Rekrutimi i stafit është kryer nga institucioni në bashkëpunim me DAP, bazuar në ligjin "Për nëpunësin civil". Nuk u konstatuan parregullsi.

Nga auditimi për respektimin e strukturës organike të miratuar, rezultoi se:

- Gjatë periudhës korrik - dhjetor të vitit 2023 struktura ka funksionuar

- me 15 veta nga 16 në strukturë me një pozicion specialisti vakant.
- Gjatë vitit 2024 struktura ka funksionuar me 15 veta nga 16 në strukturë me një pozicion specialist vakant.
- Gjatë 7 muajit 2025 struktura ka funksionuar deri në muajin mars me 15 veta dhe në mars është plotësuar pozicioni vakant.

Aktualisht struktura e institucionit është e plotësuar dhe nuk ka pozicione vakante.

Dosjet e personelit janë të pajisura me fletën e inventarit dhe fletën prezantuese të dosjes së personelit sipas VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit". Secila dosje ishte e inventarizuar (fletën e inventarit) si dhe fletën prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit, në përputhje me aktet në fuqi.

Përsa i përket përshkrimeve të punës së punonjësve, rezultoi se janë hartuar dhe miratuar, sipas udhëzimit nr. 1 datë 31.05.2017 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil", për çdo punonjës sipas sektorit përkatës dhe janë të firmosura sipas hierarkisë. U verifikuan përshkrimet (tek burimet njerzore) dhe rezultoi se ato ishin të firmosura nga punonjësit e emëruar, dhe të firmosura sipas hierarkisë në përputhje me aktet në fuqi për hartimin e përshkrimeve të pozicioneve të punës.

Përsa i përket aftësive profesionale të punonjësve, rezultoi se rekrutimi i stafit është bërë bazuar në kërkesat e vendosura për pozicionet e punës të cilat ishin dërguar dhe në DAP. Kriteret e punës për secilin pozicion ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.

Për sa i përket vlerësimeve mbi performancën e punës së stafit, rezultoi se janë plotësuar formularët e vlerësimit në punë për nëpunësit civilë të cilat janë bërë pjesë e dosjes së personelit. Vlerësimet për nëpunësit civil janë kryer për periudha 6 mujore të çdo viti. U verifikuan 9 raste vlerësimesh dhe nuk u konstatuan parregullsi.

Në lidhje me trajnimin e stafit gjatë periudhës nën auditim, rezultoi se janë kryer trajnime nga ASPA dhe nga vetë stafi por me miratim të Drejtorit Ekzekutiv, për tema të ndryshme.

Menaxhimi i riskut

Risku i institucionit përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Çdo menaxher i strukturës së njësisë publike, analizon regjistrin e risqeve të strukturës së saj, identifikon risqet me nivel të lartë dhe përgatit planin e veprimit për minimizimin e tyre.

Nga auditimi rezultoi se për periudhën nën auditim, agjensia ka identifikuar dhe vlerësuar risqet e drejtorisë që kanë efekt në përmbushjen e objektivave të saj, ka hartuar dhe përditësuar regjistrin e riskut me urdhrë të titullarit për secilin vit. Institucioni ka ndërtuar dhe miratuar strategjinë për menaxhimin e riskut me urdhrin nr. 65 datë 19.02.2019, përditësuar për periudhën e auditimit me urdhrin nr. 114 datë 29.12.2023, dhe me urdhrin nr. 727 datë 24.05.2024, në varësi të ndryshimeve të riskut.

Aktivitetet e kontrollit

Titullarët e njësive publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuara gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Objektivi kryesor i agjensisë është nxitja, nëpërmjet asistencës financiare, e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimi i kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut, në përputhje me ligjet në fuqi, dhe me përparësitë e strategjitë e programit qeveritar, sipas fushave përkatëse.

Në lidhje me procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standart dhe të rasteve të veçanta, rezultoi se njësia vepron bazuar në rregulloren e brendshme të institucionit dhe përshkrimet e punës.

Për sa i përket sistemit të nënshkrimeve, rezultoi se të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë si nga NA ashtu dhe NZ dhe nuk u konstatuan parregullsi.

Procedurat e raportimit, mbikëqyrjes, vlerësimit të efikasitetit dhe të efektivitetit të veprimtarive të institucionit janë kryer në përputhje me rregullat në fuqi. Institucioni ka hartuar raportin vjetor mbi analizën e punës për vitet 2023, 2024 dhe 7-mujorin 2025.

Për sa i përket garantimit të ruajtjes së informacionit dhe të aktiveve të njësive (ruajtja e dokumentacionit), rezultoi se ky proces kryhet në bashkëpunim me zyrën e protokollit, në përputhje me rregullat në fuqi, për përcaktimin e niveleve të fshehtësisë së informacionit dhe kufidencialitetin. Rezultoi se nga vetë institucioni është miratuar harta e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit për proceset e punës sipas sektorëve (kërkesë e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar "Për MFK" neni 16 pika 2.

Në lidhje me zbatimin e procedurave për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, rezultoi se ato janë kryer bazuar në aktet ligjore në fuqi si udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", etj.

Informimi dhe komunikimi

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që të sigurojnë identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Informimi dhe komunikimi brenda institucionit është bërë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale. Jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare, pa përjashtuar komunikimin elektronik sipas rregullave të përcaktuara.

Nga auditimi rezultoi se Drejtori Ekzekutiv informohet rregullisht nëpërmjet komunikimit gojor, memove, raporteve të monitorimit dhe analizës vjetore.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësive, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur.

Organet drejtuese të AMSHC-së informohen vazhdimisht nga punonjësit sipas nivelit hierarkik mbi aktivitetin dhe detyrat që ato realizojnë çdo ditë në muaj. Sistemi i monitorimit të kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi dhe vlerësimeve të shkëputura.

Duke ju referuar zbatimit të ligjit të MFK-së, institucioni ka bërë vlerësimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për secilin vit, institucioni në zbatim dhe në përputhje me ligjit 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe udhëzimit të MF-së nr. 28 datë 15.12.2021 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", i ndryshuar, me Udhëzimin, nr.2, datë 26.1.2024, "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike, ka përcjellë brenda afatit pranë MF:

- pyetsorin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollin,
- deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm
- raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm
- planin e veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin,

Respektivisht, për vitin 2023 materiali është dërguar me shkresën nr.115 datë 08.02.2024, dhe për vitin 2024 është dërguar me shkresën nr.93 datë 10.02.2025.

Për sa më lart rezulton se procesi i monitorimit është nën kontroll të vazhdueshëm nga drejtuesi i njësisë,

Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të MFK-së kryhet nëpërmjet:

- Monitorimit të vazhdueshëm nga të gjithë menaxherët,
- Vetëvlerësimi,
- Auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Sipas rregullave në fuqi, në fushën e monitorimit të sistemeve, titullari i njësisë, ndër të tjera, duhet të garantojë vendosjen e linjarve të qarta të raportimit sipas hierarkisë lidhur me rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së detyrave të kërkuara, etj, marrjen e informacioneve të përshtatshme në kohën e duhur lidhur me të metat e zbuluara në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit: krijimin e një sistemi për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve (pika 4.2.12 e manualit të MFK).

Sistemi i monitorimit është ngritur bazuar në një raportim periodik dhe vjetor mbi ecurinë e veprimtarisë vjetore, raport të cilin institucioni e paraqet çdo vit në Bordin e Mbikqyrjes dhe në Kryeministri.

Gjithashtu me urdhër të brendshëm nr. 1113 datë 29.12.2023 dhe vendim të bordit nr.40 datë 24.01.2024 është hartuar struktura e ndërtimit të raportit vjetor të veprimtarisë së institucionit, aktivitetet që do të përfshihen në raportim për secilin sektor, afatin kur do hartohet/raportohet dhe autoritetin ku do raportohet.

Nga shqyrtimi i raporteve vjetore 2023 dhe 2024 të AMSHC- së publikuar në faqen zyrtare u konstatua se në raport është përfshirë informacion i përgjithshëm mbi veprimtarinë e Bordit Mbikëqyrës në fushën e shqyrtimit dhe miratimit të projekti-propozimeve të shpallura fituese si dhe informacion

	mbi numrin e aplikimeve, numrin e organizatave të shpallura fituese për çdo thirrje, numrin e organizatave të skualifikuara, etj. <i>Konkluzion: Për sa trajtuar me sipër arrijmë në konkluzionin se njësisia ka një sistem të kontrollit të brendshëm që funksionon mirë dhe vlerësimi i KB- i gjelbër .(vlerësim 1)</i>
	Nuk ka gjetje nuk ka rekomandime

GJETJET SIPAS FUSHAVE:

II. AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË.

MASA NR 2	
LIDHJA ME PROGRAMIN E AUDITIMIT	II. AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË.
	- Respektimi i rregullave të brendshme dhe të jashtme që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. - Funksionimi i strukturave të drejtimit dhe administrimit. - Zbatimi i procedurave në fushën e shpërndarjes së granteve për projektpropozimet e OJF-ve përfituese.
GJETJA	- Bordi ka funksionuar në përputhje me rregullat në fuqi. Aktualisht bordi funksionon me 7 veta nga 9 të miratuar pasi në prill 2023 ka dhënë dorëheqjen një anëtar dhe në mars 2025 ka dhënë dorëheqjen ish kryetarja e bordit. - Në vitin 2023 për thirrjen nr. 16, janë shpallur fitues 64 projekt propozime ose 45.4% e kandidatëve pjesëmarrës (nga 141 pjesëmarrës) dhe janë skualifikuar 77 kandidatë, prej të cilëve 41 projekt propozime për mungesa në dokumentacion, - Në vitin 2024 për thirrjen nr. 17 janë shpallur fitues 73 projekt propozime ose 48.3% dhe janë skualifikuar 78 kandidatë (nga 151 pjesëmarrës), prej të cilëve 40 projekt propozime për mungesa në dokumentacion, - Në vitin 2025 për thirrjen nr. 18 janë shpallur fitues 76 projekt propozime ose 47.5% (nga 160 pjesëmarrës) dhe janë skualifikuar 84 kandidatë prej të cilëve 60 projekt propozime për mungesa në dokumentacion. - Kishte raste që shuma e projektit të propozuar kishte një buxhet më të madh se buxheti i akorduar nga AMSHC. Në këto raste subjekti ka deklaruar se do të mbulojë vetë diferencën e burimeve për financimin e plotë të projektit - Janë përgatitur raportet narrative për monitorimin e zbatimit të projekteve përfituese dhe janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit financiar, sipas rregullave.
PËRSHKRIMI I GJETJES	1. <i>Respektimi i rregullave të brendshme dhe të jashtme që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. Funksionimi i strukturave të drejtimit dhe administrimit.</i> Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC). është ent publik qëndror buxhetor. Veprimtaria e saj rregullohet me ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e AMSHC”, Statutin e Agjencisë, vendime të Këshillit të Ministrave, rregulloren e brendshme të agjencisë, rregulloren mbi procedurat e financimit me grante si dhe udhëzimin mbi monitorimin financiar. Për realizimin e misionit të saj, AMSHC-ja ofron asistencë financiare për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse,

bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera, që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj.

Autoritetet financuese, në kuptim të këtij ligji, shpërndajnë fonde për mbështetje të shoqërisë civile, në bazë të konkurimit të hapur e të përzgjedhjes publike të projektpropozimeve, në përputhje me parimet dhe procedurën e përcaktuar në këtë ligj.

Projektpropozimet vlerësohen në bazë të përputhshmërisë së tyre me qëllimet e programit për të cilin janë propozuar, afësisë së kandidatit dhe efektshmërisë së veprimtarive për sa u përket rezultateve e kostove. Kriteret e hollësishme për vlerësimin për çdo grant shpallen publikisht. Këto kriteret nuk mund të ndryshohen gjatë gjithë procedurës përkatëse.

Bazuar në nenin 30 të ligjit, organet drejtuese të AMSHC kanë hartuar aktet nënligjore në zbatim të pikave 2 e 3 të nenit 15 të këtij ligji, ku me vendim të KM është miratuar statuti dhe struktura e AMSHC.

➤ **Funksionimi i strukturave të drejtimit dhe administrimit.**

Strukturat drejtuese të AMSHC janë: Bordi Mbikqyrës dhe Drejtori Ekzekutiv. **Bordi Mbikqyrës i AMSHC-së**, është ngritur dhe funksionon bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 10093 "Për organizimin dhe funksionimin e AMSHC", si organ drejtues i saj.

Bordi Mbikqyrës i AMSHC-së përbëhet nga 9 anëtarë. Katër anëtarë të tij janë përfaqësues të institucioneve të administratës publike qendrore dhe 5 anëtarë përfaqësojnë organizatat e shoqërisë civile. Procedura për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të bordit mbikqyrës është e përcaktuar në nenin 9 të statutit të AMSHC.

Detyrat dhe kompetencat e bordit janë të përcaktuara në nenin 9, 10, 11 të ligjit. Bordi aktual është i emëruar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe është në ushtrimin e mandatit të parë. Aktualisht kanë dhënë dorëheqjen dy anëtarë të bordit. AMSHC ka njoftuar Këshillin e Ministrave për shpalljen e vakancave. Gjatë periudhës nën auditim, rezultoi se funksionimi i bordit ka qenë në përputhje me rregullat.

Bazuar në procedurat e miratuara për këtë periudhë bordi mbikqyrës është mbledhur dhe ka marrë vendime për çështjet e shqyrtuara sa më poshtë:

Për 6-mujorin II të vitit 2023, Bordi Mbikqyrës ka zhvilluar 1 mbledhje.

Në mbledhjen e datës 11.08.2023, është diskutuar ankesa e subjekti "ABC Tirana Club" e datës 06.07.2023 me lëndë "Kërkesë për rishikim të vlerësimit të projekt-propozimit të organizatës në kuadër të thirrjes nr. 16". Bordi Mbikqyrës vendosi pranimin e pjesshëm të kërkesës dhe mbështetjen me grant për subjektin "ABC Tirana Club" sipas vendimit nr.3 datë 18.08.2023.

Në mbledhje morrin pjesë 7 anëtarë të bordit mbikqyrës, drejtori ekzekutiv si dhe sekretarja e mbledhjes, të cilët kanë plotësuar formularin e deklarimit të konfliktit të interesit.

Për vitin 2024 Bordi Mbikqyrës ka zhvilluar 3 mbledhje:

Në mbledhjen e datës 24.01.2024, me procesverbalin nr.40 janë diskutuar:

1. Propozimi dhe miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren në fuqi të AMSHC-së (shtyrë për diskutim dhe miratim për mbledhjen e radhës)

2. Propozimi për miratimin e "Manualit të përpilimit të raportit vjetor për veprimtarinë e AMSHC-së", të hartuar me urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr.1113 datë 29.12.2023 dhe miratimin e Raportit Vjetor të vitit kalendarik 2023, sipas manualit (miratuar)

3. Kërkesa për mbështetje nga Qendra e Këshillimit të Shërbimeve Psikologjike. (nuk miratohet dhe arsyetohet ligjërisht)

Në mbledhjen e datës 19.02.2024, janë diskutuar:

- Miratimi i propozimeve të ndryshimeve të "Rregullores mbi Procedurat e Financimit me Grand në Mbështetje të Shoqërisë Civile"
- Prezantimi i propozimeve të prioritetëve të Thirrjes 17 propozuar nga aktorët e Shoqërisë Civile.
- Mbi procesin e Shpalljes së Thirrjes së rradhës të AMSHC-së, Bordi Mbikqyrës me vendimin nr.1 datë 19.02.2024, miratoi ndryshimet e propozuara për "Rregulloren mbi Procedurat e Financimit me Grand në Mbështetje të Shoqërisë Civile", miratimin e prioritetëve, shumës maksimale të financimit me grand si dhe kohëzgjatjen e projekt-propozimeve, të Thirrjes nr.17.

Në mbledhje merrnin pjesë 8 anëtarë të bordit, drejtori ekzekutiv si dhe sekretarja e mbledhjes, të cilët kanë plotësuar formularin e deklarimit të konfliktit të interesit.

Në mbledhjen e datës 23.04.2024, Bordi Mbikqyrës shqyrtoi rendin e ditës dhe vendosi:

- miratimin dhe mbështetjen me grand për 73 projekt-propozime,
- skemën e shpërndarjes së mbështetjes 50% të fondit të miratuar si paradhënie, 40% pas paraqitjes së raportit afat-mesëm dhe mbetja prej 10% e fondit të akorduar do të jepet pas miratimit të raportit final,
- miratimin e draft kontratës që do të lidhet midis Autoritetit Financues dhe atij Përfitues,
- shumat e financimit dhe kohëzgjatjen për çdo projekt-propozim .

Në mbledhje merrnin pjesë 8 anëtarë të bordit, drejtori ekzekutiv si dhe sekretarja e bordit, të cilët kanë plotësuar formularin e deklarimit të konfliktit të interesit.

Për vitin 2025 Bordi Mbikqyrës ka zhvilluar 3 mbledhje:

Bordi Mbikqyrës në mbledhjen e datës 12.02.2025, me vendimin nr.1 të po kësaj date, shqyrtoi rendin e ditës dhe vendosi:

- Miratimin e raportit vjetor kalendarik për vitin 2024 mbi veprimtarinë e AMSHC-së,
- Përcaktimin dhe nisjen e takimeve konsultative nga staff i AMSHC-së me OJF-të e qarqeve të Shqipërisë për mbledhjen e përparësive të Thirrjes 18,

Bordi Mbikqyrës në mbledhjen e datës 14.04.2025, me vendimin nr.2 të po kësaj date, shqyrtoi rendin e ditës dhe vendosi:

- Miratimin e përparësive për Thirrjen 18, sipas relacionit bashkangjitur vendimit,
- Shuma maksimale e financimit do të jetë deri në 2 (dy) milion lek dhe kohëzgjatja e projekt-propozimeve do të jetë 6 deri 12 muaj kalendarikë.
- Miratimi i draft-dokumentacionit ligjor në lidhje me dokumentacionin që Aplikantët do të depozitojnë për t'u bërë pjesë e Thirrjes nr. 18.

- AMSHC para publikimit të I hirrjes nr. 18 duhet të marri mendim nga KQZ për këtë proces, në përputhje me ligjin nr. 10019/2008 “Kodin zgjedhor të Republikës Shqipërisë”.

Bordi Mbikqyrës në mbledhjen e datës 07.07.2025 me vendimin nr.3 të po kësaj date, shqyrtoi rendin e ditës dhe vendosi:

- Miratimin dhe mbështetjen me grand për 76 projekt-propozime,
- Skemën e shpërndarjes së mbështetjes, 70% të fondit të miratuar si paradhënie, 20% pas paraqitjes së raportit afat-mesëm dhe mbetja prej 10% e fondit të akorduar do të jepet pas miratimit të raportit final,
- Miratimin e draft kontratës që do të lidhet midis Autoritetit Financues dhe atij Përfutues,
- Shumat e financimit dhe kohëzgjatjen për çdo projekt-propozim.

Në mbledhje merrnin pjesë 7 anëtarë të bordit, drejtori ekzekutiv si dhe sekretarja e bordit, të cilët kanë plotësuar formularin e deklarimit të konfliktit të interesit.

Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit Mbikqyrës për shqyrtimin dhe miratimin e Projekt-propozimeve u konstatua referuar nenit 6, shkronja ‘dh’, nenit 14 të ligjit, nenit 20 të Statutit të AMSHC-së, mbi konfliktin e interesit deri në shkallë të dytë, në procesin e vlerësimit dhe miratimit të kandidatëve fitues për financimin e projekt-propozimeve me grante nga AMSHC, anëtarët e Bordit Mbikqyrës kanë deklaruar kushtet e konfliktit të interesit.

Përsa i perket sanksioneve që duhet të aplikohen në rastet e mosrespektimit të kushteve të kontratës, rezulton se ato janë përfshirë në kontratat tip që lidhen me aplikuesit/fituesit (nenin 16 të “Kontratës tip”).

Aktualisht nuk ka subjekte që tu jenë aplikuar sanksione sa më sipër.

Sipas ligjit, në nenin 9. “detyrat dhe kompetencat e Bordit”, pika g. ndër të tjera rezulton se Bordi Mbikqyrës ka si detyrë edhe të raportojë në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e AMSHC-së:

Nga verifikimi rezultoi se raporti vjetor i veprimtarisë së AMSHC-së është dërguar çdo vit në KM me e-mail dhe me shkresë zyrtare.

Për vitin 2023 “Raporti Vjetor i veprimtarisë së AMSHC” është dërguar në KM me shkresën nr.86 datë 5.2.2024.

Për vitin 2024 “Raporti Vjetor i veprimtarisë së AMSHC” është dërguar me shkresën nr.212 datë 28.3.2025.

Si konkluzion rezulton se gjatë periudhës nën auditim, funksionimi i bordit ka qenë në përputhje me rregullat në fuqi duke konstatua se bordi nuk është i plotësuar në numër, e konkretisht:

Për periudhën nën auditim bordi ka funksionuar me mungesa pasi njëri nga anëtarët e bordit z.B.Gjokutaj është larguar me dorëheqje që në prill të vitit 2023 dhe akoma nuk është bërë zëvendësimi i tij, gjithashtu në mars të vitit 2025 është larguar me dorëheqje anëtarja e njëkohësisht ish kryetare e bordit zj. I.Luarasi.

Aktualisht bordi funksionon me 7 veta nga 9 që duhet të ketë në strukturë. Nga ana e strukturës është kërkuar në KM proceduralisht plotësimi i anëtarëve të bordit me vendim qeverie por akoma nuk është realizuar, (rek)

2. Zbatimi i procedurave në fushën e shpërndarjes së granteve për projektpropozimet e OJF-ve përfutuese.

Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) ka si mision të shpërndajë fonde për mbështetje të shoqërisë civile, në bazë të konkurrimit të hapur e të përzgjedhjes publike të projekt-propozimeve, në përputhje me parimet dhe procedurat e përcaktuara me ligj.

Për periudhën objekt auditimi agjencia ka shpallur 3 thirrje (16, 17 dhe 18) për shpërndarje granti dhe fushën e prioritetëve të thirrjes (2023-2025). Thirrja 16 dhe 17 ka përfunduar monitorimi/zbatim, ndërsa thirrja 18 është në proces. Për çdo thirrje të shpallur, AMSHC ka hartuar regjistrin e kandidatëve pjesëmarrës që kanë dorëzuar projektpropozimet për financim. Në zbatim të ligjit, Drejtori Ekzekutiv ka ngritur komisionin e vlerësimit të projekt-propozimeve.

Të dhënat mbi prioritetet, regjistrin e kandidatëve, projekt-propozimet fitues dhe projekt-propozimet jofitues për secilën thirrje, jepen sa më poshtë:

➤ **Fushat e prioritetëve të Thirrjes Nr. 16.**

1. Shërbimet Sociale dhe Rinia;
2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi ligjor i Publikut dhe SKZHI: (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahet)
3. Mjedis, Mbrojtja dhe Projekte të lidhura me të;
4. Arsimi, Integrimi European dhe Politikbërja;

➤ **Fushat e prioritetëve të Thirrjes Nr. 17**

1. Forcimi i drejtësisë dhe llogaridhënies: qasje novatore në monitorimin e reformës në drejtësi dhe rritjen e rolit të mediave investigative në luftën kundër korrupsionit.
2. Fuqizimi i Gjeneratës së ardhshme: Nxitja e të drejtave të sëmijëve dhe të rinjve përmes promovimit të talenteve artistike, integrimit në komunitet, vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimit për shëndetin seksual.
3. Rritja e mirëqenies së komunitetit përmes qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse: Forcimi i qeverisjes vendore, edukimi profesional dhe shërbimet sociale për gratë, të rinjtë, të moshuarit, minoritetet dhe njerëzit me aftësi të ndryshme.
4. Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Mbrojtja e Mjedisit: Rritja e Zonave Natyrore Rajonale për Turizmin, Mbështetja e Ruajtjes së Pyjeve dhe Burimeve Termale, Promovimi i Turizmit Familjar me fokus në produktet tradicionale përballë kërcënimit të zhvillimit ekonomik
5. Forcimi i themeleve të Integrimit Evropian: Rritja e Demokracisë dhe Fuqizimi i Shoqërisë Civile.
6. Dimension i digjital për dhunën ndaj grave

➤ **Fushat e prioritetëve të Thirrjes Nr. 18:**

1. Qeverisja e mirë dhe antikorupsioni
2. Përfshirje sociale, të drejtat e njeriut dhe fuqizimi i grupeve të marginalizuara
3. Zhvillimi ekonomik, punësimi dhe inovacioni
4. Mbrojtja e mjedisit dhe tranzicioni i gjelbër
5. Kultura, arsimi, shëndeti dhe trashëgimia

Prioritetet e shpallura për secilën thirrje janë miratuar nga Bordi Mbikqyrës.

Të dhënat sipas regjistrit të kandidatëve që kanë dorëzuar projekt-propozime për financim për të tre thirrjet jepen në pasqyrën sa më poshtë:

000/lekë

Emërtimi	Projekt-propozime të paraqitura nga OJF		Projektpropozime të miratuara	
	Nr	Vlera e kërkuar nga OJF për tu financuar nga AMSHC	Nr	Vlera e Akorduar nga Bordi i AMSHC-së
Thirrja 16	141	283,167	64	95,500
Thirrja 17	151	267,800	73	96,500
Thirrja 18	160	272,452	76	107,600

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se:

Për thirrjen 16 nga 141 kërkesa për financim janë shpallur fitues 64 projekt propozime ose 45.4% e kandidatëve pjesëmarrës dhe 77 kandidatë janë jo fitues dhe/ose të skualifikuar. Nga të cilët rezulton se, 41 prej tyre janë skualifikuar për mungesa në dokumentacionin e depozituar me aplikimin dhe 36 kandidatë janë skualifikuar për shkak të kapacitetit të aplikuesit dhe/ose për shkak të mospërputhjes së projekt propozimit me fushën e prioritetëve të caktuara në shpalljen e publikuar dhe shkaqe të tjera.

Për thirrjen 17 nga 151 kërkesa janë shpallur fitues 73 kërkesa ose 48.3% e kandidatëve pjesëmarrës dhe 78 kandidatë janë jo fitues dhe/ose të skualifikuar. Nga të cilët rezulton se, 40 prej tyre janë skualifikuar për mungesa në dokumentacionin e depozituar me aplikimin dhe 8 kanë qenë aplikime jashtë afatit. Gjithashtu 30 kandidatë janë skualifikuar për shkak të kapacitetit të aplikuesit dhe/ose për shkak të mospërputhjes së projekt propozimit me fushën e prioritetëve të caktuara në shpalljen e publikuar dhe shkaqe të tjera.

Për thirrjen 18 nga 160 kërkesa janë shpallur fitues 76 kërkesa ose 47.5% e kandidatëve pjesëmarrës dhe 84 kandidatë janë jo fitues dhe/ose të skualifikuar. Nga të cilët rezulton se, 60 prej tyre janë skualifikuar për mungesa në dokumentacionin e depozituar me aplikimin dhe 3 kanë qenë aplikime jashtë afatit. Gjithashtu 21 kandidatë janë skualifikuar për shkak të kapacitetit të aplikuesit dhe/ose për shkak të mospërputhjes së projekt propozimit me fushën e prioritetëve të caktuara në shpalljen e publikuar dhe shkaqe të tjera.

Me shkresë përcjellëse nr.1050 prot datë 12.08.2025 Drejtori Ekzekutiv ka njoftuar bordin mbikqyrës nga tërheqjen e një prej OJF fituese.

Në relacionin e vlerësimit të projekt – propozimeve nga Komisioni i Vlerësimit të Projekt – Propozimeve janë evidentuar arësyet konkrete të skualifikimit për secilin aplikant/kandidat. Më pas këto relacione, bashkë me dokumentacioni shoqërues, janë paraqitur për vlerësim Bordit Mbikqyrës, i cili ka marrë vendimet përkatëse për kualifikimin apo skualifikimin sipas rastit.

Të dhënat sipas fushës së prioritetëve (programeve) për të tri thirrjet jepen sa më poshtë:

Për Projekt-propozimet fitues.

në 000 lekë

Projektpropozime sipas fushës së Prioriteteve	Thirrja Nr.16		Thirrja Nr.17		Thirrja Nr.18	
	Nr Projekt	Nr Projekt	Nr Projekt	Në vlerë	Nr Projekt	Në vlerë
Prioriteti 1	21	30,400	3	4,000	37	54,600
Prioriteti 2	14	24,200	33	42,300	6	7,600
Prioriteti 3	19	27,000	14	17,200	9	11,300
Prioriteti 4	7	10,400	12	16,900	7	10,500
Prioriteti 5			5	6,800	9	12,800
Prioriteti 6			1	1,800		
Prioriteti 7						
Me shume se nje fushe prioritare në total te ndara:	3	3,500	8	7,500	8	10,800
Në 2 priorite:	1	1,600	4	6,000	5	6,500
Në 3 priorite:	2	1,900	1	1,500	2	2,600
Në 4 Priorite:					1	1,700
Në 5 Priorite:						
Shuma	64	95,500	73	96,500	76	107,600

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se;

Për thirrjen nr.16, janë 64 projekte të shpallura fitues, nga të cilat 61 prej tyre ose 95.3 % mbështeten në një nga 4 prioritetet e para dhe 3 të tjera ose 4.7 % mbështeten në dy ose më shumë priorite të thirrjes së shpallur. Numrim më të madh të projekteve të shpallura fitues e zë prioriteti nr.1 "Forcimi i drejtësisë dhe llogaridhënies" me 21 projekte.

Për thirrjen nr.17, janë 73 projekte të shpallura fitues, nga të cilat 68 prej tyre ose 93.2 % mbështeten në një nga 6 prioritetet e para dhe 5 të tjera ose 6.8 % mbështeten në dy ose më shumë priorite të thirrjes së shpallur. Numrim më të madh të projekteve të shpallura fitues e zë prioriteti nr.2 "Fuqizimi i Gjeneratës së ardhshme" me 33 projekte.

Për thirrjen nr.18, janë 76 projekte të shpallura fitues, nga të cilat 68 prej tyre ose 89.5 % mbështeten në një nga 5 prioritetet e para dhe 8 të tjera ose 10.5 % mbështeten në dy ose më shumë priorite të thirrjes së shpallur. Numrim më të madh të projekteve të shpallura fitues e zë prioriteti nr.1 "Qeverisja e mirë dhe antikorrupsioni" me 37 projekte.

Për verifikimin mbi zbatimin e procedurave në fushën e shpërndarjes së granteve për projektpropozimet e OJF-ve përfituese, nga grupi i auditimit u përzgjedhën për auditim projekt-propozime të thirrjeve 17 dhe 18.

Nga auditimi i projektpropozimeve të përzgjedhura u konstatua se krahas planit të buxhetit të paraqitur me formularin e aplikimit, subjektet të shpallur fitues me kërkesë të AMSHC-së kanë plotësuar një plan buxheti të dytë duke ndryshuar plan buxhetin e paraqitur për financim deri në shumën e miratuar për financim nga AMSHC.

Kishte raste që shumën e projektit të propozuar kishte një buxhet më të madh se buxheti i akorduar nga AMSHC. Në këto raste subjekti ka deklaruar se do të mbulojë vetë diferencën e burimeve për financimin e plotë të projektit.

Referuar nenit 25 të ligjit "Zbatimi i kontratës" dhe të rregullores "Mbi procedurat e financimit me grante" nenin 17 "Monitorimi i zbatimit të projekteve

të financuara” u verifikuan projektet e përzgjedhura dhe nuk u konstatuan mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga përfituesit për të provuar përmbushjen e aktiviteteve të projektit dhe dokumentimin financiar të grantit të dhënë nga AMSHC.

Personat e ngarkuar për monitorimin e zbatimit të projekteve të financuara nga AMSHC kanë hartuar dy raporte të veçanta: njërin mbi përmbushjen e aktiviteteve të projektit dhe tjetrin për raportimin e monitorimit financiar, të cilat administrohen në dy dosje të ndara pasi monitorimi i tyre bëhet në intervale kohe të ndryshme.

Për rastet e verifikuara rezultoi se dokumentacioni financiar i paraqitur nga përfituesi mbi justifikimin e përdorimit të fondit ishte i plotë dhe konform bazës rregullative në fuqi për veprimtarinë e këtij institucioni. Gjithashtu rezultoi se ky dokumentacion është pranuar duke mbajtur procesverbalet e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit financiar, duke bërë nënshkrimin dhe vulosjen e tyre me qëllim që i njëti shpenzim të mos i paraqitet edhe një financuesi tjetër.

Sektori i Administrimit të Programeve të Grantëve dhe Zhvillimit Rajonal kryen monitorimin e aktiviteteve për projektet fituese që nga nënshkrimi i kontratës midis OJF-ve fituese dhe AMSHC-së, deri në finalizimin e saj.

Rezultoi se për secilën thirrje të shpallur, ky sektor në bashkëpunim dhe me sektorin e financës ka ushtruar dhe mbikëqyrur projektet përfituese për dy thirjet e para sipas tabelës më poshtë:

Emërtimi	Nr. i projekt propozimeve të miratuara	Vlera e Akorduar	Procesi i Monitorimit i OJF fituese	
			Monitorimi nga zyra (sa në numëri)	Monitorimi në terren (sa në numër)
Thirrja 16	64	95,500	43	21
Thirrja 17	73	96,500	45	28
Thirrja 18	76	107,600	76/Në proces	Në proces

Sipas tabelës së mësipërme rezulton se për secilën thirrje (16 dhe 17) është bërë edhe procesi i monitorimit të OJF-ve. Ky proces është kryer si nga zyra ashtu dhe monitorim në terren.

Për thirrjen 18 rezulton se gjatë procesit të auditimit është rezauruar shpallja e fituesve të kësaj thirrje dhe janë lidhur kontratat me 76 fitues. Janë zhvilluar takime konsultative në ambjentet e AMSHC-së me përfaqësues stafin e këtij institucioni dhe përfaqësues të OJF-ve fituese për të shpjeguar të gjitha procedurat që do të ndjekin përfituesit nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri në rezaurimin e plotë të zbatimit të projekt-propozimeve. Deri në fund të muajit korrik 2025 janë nënshkruar 69 kontrata nga 76 të shpallura fituese, midis AMSHC në cilësinë e autoritetit financiar dhe OJF-ve në cilësinë e përfituesve.

Sa më lart nuk u konstatuan parregullsi.

BAZA
RREGULLAT
ORE

- Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, i ndryshuar.

PROBLEMATIKA KONSTATUAR	Për periudhën nën auditim bordi ka funksionuar me mungesa pasi njëri nga anëtarët e bordit është larguar me dorëheqje që në prill të vitit 2023 dhe akoma nuk është bërë zëvendësimi i tij, gjithashtu në mars të vitit 2025 është larguar me dorëheqje ish kryetari e bordit. Aktualisht bordi funksionon me 7 veta nga 9 që duhen. Nga ana e strukturës është kërkuar në KM zyrtarisht plotësimi i anëtarëve të bordit me vendim qeverie por akoma nuk është realizuar.
EVIDENCA GJETJES	- Ligji nr. 10093 datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile". Neni 8 "Përbërja dhe emërimi i bordit mbikëqyrës" - Doreheqja e dy anëtarëve nr. 197 datë 17.03.2025 dhe email datë 24.02.2023 - (Trajtuar faqe 12-14 të raportit)
IMPAKTI GJETJES	Mungesa e anëtarëve të bordit ndikon në shqyrtimin dhe vendimarrjen e çështjeve që i kalojnë bordit si dhe në ecurinë e procesit.
RËNDËSIA/RIKREKOMANDIMI	I mesëm <i>Agjencia për mbështetjen e shoqërisë civile, të vijojë procedurat për plotësimin e bordit me anëtarë të rinj deri në emërimin e tyre.</i>
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit pas observacionit	Është pranuar.

Gjetje sipas fushave

III. Auditimi financiar

MASA NR 4	
LIDHJA ME PROGRAMIN AUDITIMIT	1. AUDITIMI FINANCIAR 1. Zbatimi i rregullave në hartimin, miratimin e planit të buxhetit për periudhën nën auditim. 2. Zbatimi i rregullave në kryerjen e shpenzimeve, respektimi i limiteve të shpenzimeve. Zbatimi i procedurave të planifikimit dhe kryerjes së prokurimeve publike. 3. Zbatimi i rregullave në mbajtjen e kontabilitetit, inventarizimin, përgatitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare.
GJETJA	- Për periudhën 6-M II 2023, 2024 dhe 7-M 2025, institucioni ka përfituar fonde nga buxheti i shtetit për shpenzime korente, grande dhe investime kapitale. - Detajimi i buxhetit dhe ndryshimet në buxhet janë bërë në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". Janë mbajtur akt-rakordimet për shpenzimet, të cilat kanë disa problematika për sa i përket plan buxhetit dhe plan thesarit, dhe janë përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Procedurat mbi zbatimin e kritereve për detajimin, rialokimin dhe

transferimin e fondeve buxhetore janë bërë në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

- Realizimi i buxhetit për vitin 2023 ka qenë në masën 99 %, për vitin 2024 në masën 98% dhe për 7 mujorin 2025 realizimi i shpenzimeve ka qenë në masën 44% e llogaritur kjo mbi planin vjetor. Për vitin 2025 realizimi i buxhetit është në proces. Në dinamikë fondet buxhetore vjetore të planifikuara kanë patur trend rritës.
- Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore në vitet 2023 dhe 2024 janë realizuar në masën 99%, ndërsa për periudhën 7 mujore të vitit 2025 në masën 57% e planit vjetor të miratuar. Llogaritja e pages për çdo punonjës është bërë në përputhje me aktet ligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e pagave. Përmbledhësja e pagave rakordon me pagesat e bankës.
- Për një rast nuk janë reflektuar ndryshimet në pagë, sipas vkm nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", ku pika 9 e vkm-së ka ndryshuar nivelin e shtesës për pagesë për çdo nivel shkalle vështirësie (për punonjësin e magazinës).
- Kategoria e pagave sipas VKM-së 157/2016 me të cilën është miratuar dhe struktura e AMSHC-së duhet të përshtatet si kategori me ndryshimet përkatëse në nivelin referues aktual të kategorive të pagave sipas VKM 325/2023, e ndryshuar.
- Llogaritja e kontributeve për sigurime shoqërore, shëndetësore dhe TAP dhe derdhja e tyre në favor të tatimeve është bërë në përputhje me ligjin nr. 9136 datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSh" i ndryshuar dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 16.04.2009.
- Shpenzimet faktike në Art.602 "Shpenzime operative", gjatë vitit 2024 rezultuan 18% më ulët se shpenzimet faktike të vitit 2023. Nga 5,849 mijë lekë të shpenzuara në vitin 2023, gjatë vitit 2024 janë shpenzuar 4,780 mijë lekë ose 1,069 mijë lekë më pak. Rregjistrat e parashikimit, për periudhën nën auditim janë dërguar jashtë afatit të përcaktuar në vkm nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
- Për një punonjës me kontratë të përkohshme, me emërtimin "Specialist" ka marrë ndihmë të menjëhershme financiare në shumën 15,000 lekë, jo në përputhje me pikën 1 të vkm-së, nr.846 datë 26.12.2024,
- Shpenzimet për investimet (Art.231), gjatë viteve 2023 dhe 2024 kanë rënë krahësuar periudhat e mëparshme, duke rezultuar me një realizim poshtë nivelin e 50% kundrejt planit të miratuar për investimet, përkatësisht 49% dhe 46%. Gjatë 7-mujorit 2025 nuk ka patur realizimin të investimeve.
- Në Akt-Rakordimet me degën e Thesarit përsa i përket shpenzimeve për periudhën e auditimit, u konstatuan gabime në plotësimin e tyre për periudhën nën auditim.
- Veprimet kontabile janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumentave justifikuese dhe janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

**PËRSIKRIMI
GJETJES**

- Nga shqyrtimi i rezultateve për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezultoi se nga 5 rekomandiet e lëna janë realizuar plotësisht 4 rekomandime dhe 1 është në proces zbatimi të rekomandimit.

• Zbatimi i rregullave në hartimin, miratimin e planit të buxhetit për vitin 2023, 2024 dhe 2025.

Nga auditimi për respektimin e afateve të dorëzimit të p/buxhetit në Ministrinë e Financave rezultoi se, për periudhën objekt auditimi, kërkesat për buxhet janë dorëzuar brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore për hartimin e buxhetit të shtetit.

Gjatë periudhës së auditimit, AMSHC ka përgatitur raportet përkatëse të **Programit Buxhetor Afat – Mesëm (PBA)**, PBA 2024-2026, PBA 2025-2027 si dhe 2026-2028.

Nga auditimi rezultoi se ato janë nisur me shkresë përcjellë në Ministrinë e Financës, dhe janë hedhur në sistemin AFMIS, brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me standartin e kërkuar nga Ministria e Financës sipas udhëzimeve përkatëse “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afat Mesëm”. Gjithashtu janë respektuar tavanet e programit të përcaktuara në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm”.

Kërkesat për fonde kanë qenë të argumentuara në përputhje me numrin e punonjësve të përhershëm miratuar AMSHC-së në çdo vit buxhetor, nevojave për shpenzime operative dhe investime, si dhe në përputhje me prioritetet për mbështetje për shoqërinë civile.

Nga auditimi i buxhetit të AMSHC-së për periudhën 6-M II 2023, 2024 dhe 7-M 2025, rezultoi se ky institucion ka përfutur fonde nga buxheti i shtetit për shpenzime korrente, grande dhe investime kapitale.

Plani i buxhetit të AMSHC-së është hartuar dhe detajuar sipas strukturës dhe periudhave buxhetore për secilin vit buxhetor, bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, dhe buxhetin e miratuar me ligjet për buxhetin e viteve 2023 dhe 2024 dhe 2025.

Nga auditimi u konstatua se janë zbatuar limitet për fondet buxhetore të miratuara sipas zërave të shpenzimeve për AMSHC-në në total dhe nuk ka patur tejkalim në asnjë nga zërat e shpenzimeve. Për shpenzimet operative të parashikuara për blerje mallra dhe shërbime janë respektuar fondet limit, sipas parashikimit në regjistrin e prokurimeve të hartuar në fillim të çdo viti dhe me ndryshimet e miratuara gjatë vitit.

Për periudhat nën auditim AMSHC ka përfutur fonde buxhetore dhe në pasqyrën e mëposhtme paraqitet plani përfundimtar për vitet 2023, 2024, 7-2025 duke përfshirë dhe ndryshimet gjatë vitit kalendarik (shtesa e pakësime) të miratuara nga Ministria e Financave.

në 000: lekë

Zër at	VITI BUXHETOR 2023				VITI BUXHETOR 2024				7. MUJORI 2025			
	Plani fillim	Plani rish.	Fakt	%	Plani fillim	Plani rish.	Fakt	%	Plani fillim	Plani rish.	Fakt	%
600	15170	8871	18775	45	19420	5073	19407	60	22100	2100	1000	58

600	2733	2782	2.44	9	3210	3210	3.85	93	4180	4182	3259	99
602	4700	4711	0.24	87	5295	5295	4.90	75	5358	5355	2712	14
604	107000	106901	-0.09	1.0	103300	103300	-99.70	100	104220	104021	4940	47
606	-	-	-	-	-	120	0.2	60	-	100	10	30
2.31	100	1001	402	49	1700	1700	4.50	99	1070	1090	0	0
Total	123805	123556	-0.20	99	130535	130535	-128.88	98	135875	135675	59345	44

Gjatë vitit 2023 ka patur ndryshime të planit fillestar. Konkretisht Art.600 është shtuar në vlerën 3,500 mijë lekë dhe Art.601 me 250 mijë lekë, në zbatim të vkm nr.325 datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shitesave të tjera mbi pagë të...punësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike". Art.602 është shtuar me 2,000 mijë lekë duke pakësuar Art.604 po me 2,000 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024, është shtuar plani në Art.600 në shumën 250 mijë lekë, në zbatim të vkm nr.421 datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shitesave të tjera mbi pagë të...punonjësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike".

Gjithashtu janë miratuar gjatë vitit 2024 dhe 2025 edhe shuma 100 mijë lekë në zërin 606, për përdorim nga fondi veçantë. Gjatë periudhës 7-M 2025 nuk ka patur ndryshime të tjera të planit. Shitesat dhe pakësimet në zërat e shpenzimeve janë të argumentuara dhe të kryera me procedura ligjore të rregullta.

Nga auditimi i procedurave mbi zbatimin e kriterëve për detajimin, rialokimin dhe transferimin e fondeve buxhetore rezultoi se ato janë hërë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe nuk u konstatuan parregullsia.

Në dinamikë fondet buxhetore vjetore të planifikuara kanë patur trend rritës. Në vitin 2024 fondet buxhetore vjetore të planifikuara arritën vlerën 130,875 mijë lekë, duke u rritur me 2.6 % krahasuar me fondet buxhetore të planifikuara të vitit 2023 dhe në vitin 2025 fondet buxhetore të planifikuara arritën vlerën 135,675 mijë lekë, me një rritje prej 3.7% krahasuar me ato të vitit 2024.

Nga verifikimi i Akt-Rakordimeve me Degen e Thesarit përsa i përket shpenzimeve për periudhën e auditimit, u konstatuan gabime në plotësimin e tyre për periudhën dhjetor 2023, dhjetor 2024 dhe 6 muor 2025.

Konkretisht në akt-rakordin e muajit dhjetor 2023 për Art.602 mungon totali plarëfakti. Gjithashtu plan thesari 6029999 duhet të vendoset në rreshtin përkatës dhe jo në të njëjtin rresht me Art.604.

Përsa i përket akt-rakordimit të muajit dhjetor 2024, u konstatua se mungon shuma e plan thesarit total, shuma 602999 është vendosur në rreshtin e gabuar, shuma 600999 nuk korrespondon me shumën e Art.600+Art.601, dhe shpenzimet faktike në Art.600 rezultojnë më të mëdha se plani i buxhetit përkatës. Gjithashtu mungon plani i buxhetit për Art.606, megjithëse ka shpenzim faktik. Në akt-rakordin e muajit qershor 2025 u evidentuan të njëjtat problematika si në akt-rakordin e muajit dhjetor 2024. (Rek)

Realizimi i buxhetit për vitin 2023 ka qenë në masën 99 %, për vitin 2024 në masën 98% dhe për 7 mujorin 2025 realizimi i shpenzimeve ka qenë në masën 44% e (llogaritur kjo mbi planin vjetor). Për vitin 2025 realizimi i buxhetit është në proces.

- Zbatimi i rregullave në kryerjen e shpenzimeve, respektimi i limiteve të shpenzimeve. Zbatimi i procedurave të planifikimit dhe kryerjes së prokurimeve publike.

Shpenzimet faktike gjatë vitit 2024 (si vit i plotë buxhetor për periudhën e auditimit) arritën vlerën 128,100 mijë lekë, duke rezultuar me një rritje prej 1,9% krahasuar me shpenzimet faktike në vitin 2023, me një realizim 98% kundrejt planit buxhetor 2024.

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar sipas planifikimit të bërë mbi numrin total të punonjësve në strukturë.

Shpenzimet faktike në zërin paga (Art.600) dhe sigurime shoqërore (Art.601) gjatë vitit 2024, rezultuan në shumën 23,054 mijë lekë, duke zënë 18% të totalit në strukturën e shpenzimeve të këtij viti, si dhe rezultuan me një rritje prej 7% krahasuar me vitin 2023.

Më poshtë po paraqesim gjetjet e konstatuara gjatë auditimit financiar.

Numri total i punonjësve të përhershëm është i miratuar me VKM nr.157 datë 02.03.2016 “Për miratimin e Statutit të AMSHC” ku është e përfshirë dhe struktura me 16 punonjës. Rezulton se aktualisht kategoria e pagave sipas kësaj VKM-je/strukture nuk përputhet me kategorinë e pagave që është e miratuar/ndryshuar me vkm nr. 325/2023, dhe që është aplikuar dhe nga AMSHC, si e tillë është e nevojshme që kategoria e pagave që stafi i AMSHC përfiton duhet të përshtatet si kategori dhe tek struktura e miratuar e agjensisë me ndryshimet përkatëse në nivelin referues aktual të kategorive të pagave. (VKM 325/2023 lidhja I, pika I paragrafi c).

Sa me lart kokludojmë se kategoria e pagave në këtë vendim dhe që aktualisht e kanë aplikuar dhe e përfitojnë punonjësit e AMSHC-së me kategorinë e pagave të përcaktuar në strukturën e miratuar duhet të jetë e njëjtë.

Niveli i pagave për punonjësit e përhershëm është përllogaritur në përputhje me VKM nr.325 datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” si dhe VKM nr.421 datë 26.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023...”

Gjithashtu AMSHC ka patur në organikën e saj edhe 2 punonjës me kontratë të përkohshme (një specialist dhe një sanitarë 6 orë/ditë), miratuar për çdo vit me VKM përkatëse “Për përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin (2023, 2024, 2025) në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, respektivisht: VKM nr.56, datë 01.02.2023; VKM nr.39, datë 24.01.2024; VKM nr.19, datë 09.01.2025.

Niveli i pagave për punonjësit mbështetës është përllogaritur në përputhje me VKM nr.326 datë 31.05.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të

administratës publike” si dhe VKM nr.422 datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023...”.

Në zbatim të ndryshime në nivelin e kategorisë së pagave, institucioni ka përlogaritur dhe paguar pagat e reja si dhe ka bërë rideklarimin e tyre për muajt prill-maj 2023 në sistemin elektronik të tatimeve.

Institucioni ka mbajtur regjistrin e pagave të punonjësve duke azhurnuar të gjitha lëvizjet sipas dokumentacionit vërtetues, vendimet e fillimit apo ndërprerjes së marrëdhënieve financiare sipas rastit. Deklarimet e lëvizjeve dhe ndryshimit të punonjësve, punësimit dhe largimet janë rregjistruar në sistemin e tatimeve *e-filing* brenda periudhave që parashikon ligji. Gjatë periudhës së auditimit ka patur 3 shtesa dhe 2 largime të numrit të punonjësve.

Nga kontrolli i urdhër shpenzimeve lidhur veprimet për pagesën e pagave dhe sigurimeve shoqërore, shëndetsore etj, u konkludua se listpagesat për pagat janë kryer brenda ditëve të para të muajit pasardhës, në përputhje me strukturën dhe organikën e institucionit, strukturën dhe klasifikimin e pagave, dhe legjislacionin në fuqi. Deklarimet e pagave dhe detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, në sistemin *e-filing*, janë bërë brenda afatit të përcaktuar dhe në përputhje me aktet në fuqi. Pagesa e kontributeve tatimore është bërë brenda datës 20 të çdo muaji. Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin e tatimeve *e-filing*, rezultoi se institucioni nuk kishte detyrime të papaguara, gjoha apo kamatvonesa.

Nga verifikimi i list pagesave rezultoi se vetëm magazinieri përfiton një shtesë mbi pagë për vështirësi në punë dhe dëmshmëri në shëndet në shumën 5,330 lekë. (urdhër shpenzimi nr.1 datë 06.01.2025 dhe nr. 148 datë 01.08.2025. date) Dokumentacioni përkatës për përfitimin e kësaj shtese mbi pagë rezultoi i plotë dhe në përputhje me vkm nr.717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

Me shkresën nr.650/1 datë 16.05.2018, Autoriteti Shëndetsor Rajonal Tiranë (Drejtoria e Shëndetit Publik) ka përcaktuar shkallën e vështirësisë së I-rë pika a (1.335 lekë), dhe të II-të pika f (4.005 lekë). Gjithashtu është marrë miratimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Ministrisë përgjegjëse për financat. Gjatë periudhës së auditimit, shtesa e pagës për magazinierin ka vazhduar në shumën 5,330 lekë.

Nga auditimit u konstatua se institucioni nuk ka reflektuar ndryshimet në pagë, sipas VKM nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”. Pika 9 e vkm-së ka ndryshuar nivelin e shtesës për pagesë për çdo nivel shkalle vështirësie.

Pika 9 thekson se. “Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesë mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, si më poshtë vijon: a) Në shkallën e parë, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj; b) Në shkallën e dytë, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj”;

Pika 15 thekson se “Efekti financiar, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për këtë vit”.

Grupi i auditimit konstatoi se, shuma e shtesës mbi pagë për vështirësi në punë dhe dëmshmëri në shëndet, që i takon magazinierit duhet të ishte 6,000 dhe jo 5,330 lekë. Duhet bërë ndryshimi i shumës së shtesës mbi pagë për punë të vështirësi për shëndetin, në zbatim të pikës 9 dhe 15, në 6,000 lekë/muaj, me një diferencë nga ajo aktuale prej 670 lekë/muaj.(rek)

Një nga detyrat kryesore të sektorit të financës, është regjistrimi i shpenzimeve të dorëzuara nga institucionet buxhetore nëpërmjet sistemit online për institucionet të cilat operojnë me Eeb Portal, duke ngarkuar urdhër shpenzimet dhe dokumentat. Ky proces është kryer dhe vazhdon të kryhet kryhet në përputhje me rregullat në fuqi.

Gjatë periudhës së auditimit, në zbatim të vkm nr.795, datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të ASQUIS (SCREENING), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian", si dhe shkresës së Ministrisë së Drejtësisë, me nr.57/4 datë 08.01.2024 "Mbi konfirmimin e listës së punonjësve që përfitojnë shpërblim sipas shkronjës "b" të pikës 1, të VKM nr.795, datë 28.12.2023, u është dhënë shpërblim 2 persona.

Shpërblimi është dhënë në masën e një page mujore bruto, referuar vkm nr.795, datë 28.12.2023, pika 2 "Masa e shpërblimit të jetë një pagë mujore bruto, sipas pagës që nëpunësit përfitues, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, kanë në momentin e hyrjes në fuqi të tij, por jo më shumë se paga e funksionit Ministër Shteti dhe Kryenegociator, dhe për një shpërblim të vetëm".

Rezulton se bazuar në VKM nr.834 datë, datë 28.12.2023 për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar, dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione", u është dhënë shpërblim nga institucioni 3 personave në shumën bruto 10 mijë lekë me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv nr.14 datë 12.01.2023. Ekzekutimi i pagesës është bërë me urdhër shpenzimit nr. 12 datë 15.01.2024.

Të gjitha veprimet për pagat, shpërblimet apo ndihmat e menjëhershme institucioni i ka kryer pranë Bankës Kombëtare Tregtare, bankë në të cilën kanë hapur llogari punonjësit e institucioni.

• Përdorimi i fondeve për shpenzime operative (Llogaria 602).

Shpenzimet faktike në Art.602 "Shpenzime operative", gjatë vitit 2024 rezultuan 18% më ulët se shpenzimet faktike të vitit 2023. Nga 5,849 mijë lekë të shpenzuara në vitin 2023, gjatë vitit 2024 janë shpenzuar 4,780 mijë lekë ose 1,069 mijë lekë më pak.

Në pasqyrën e mëposhme është paraqitur detajimi i shpenzimeve faktike korente, për periudhat 6-mujorin 2023, 2024 dhe 7-mujori 2025 sa vijon:

Emërtesa	në (mijë) lekë		
	6-M II 2023	2024	7-M 2025
Energji elektrike	978,902	169,659	145,055
Shërbime postare e abonime	3,914	22,272	18,610
Shpenzime telefonike	62,590	91,854	42,061

-udhëtim e dieta jashtë vendit	994,902	646,326	291,500
- udhëtim e dieta brenda vendit	720,500	1,818,000	
Kancelari/printime	170,800	297,988	112,760
Mirëmbajtje të paisjeve të zyrës	80,000	430,000	
Riparime e mirëmbajtje godine	0	0	
Shërbime dhe të tjera për automjetet	97,440	629,379	12,792
Mirëmbajtje të sist financiar online	117,847	117,847	
Shpenzime për qera sallë për aktivitete	203,750	246,300	137,300
Taksa vendore	25,231	15,000	
Shpenzime honorare bordi ekzekutiv	94,350	77,350	
-ukl shpenzime	4,800	24,801	2,280
-latim në burim		73,368	9,150
-Te tjera shpenzime	124,680	119,856	
Totali	3,679,706	4,780,000	771,508

Gjatë 6-M II 2023 shpenzimet për energjinë elektrike arritën nivel të lartë, për arsye të një laturimi sistemues gjatë muajit Tetor 2023, dhe pagesës në thesar nga ana e në shumën 909,821 lekë si rezultat i konstatimit nga punonjësit e FSHU të një problematike me testimin e matësit ekzistues, dhe vendosjen e një matësi të ri. Gjatë vitit 2024 në strukturë e shpenzimeve totale, shpenzimet për Art.602, u ulën në 3,5% nga 26.7% kundrejt totalit të Art.602 që ishte në 6-mujorin e II të vitin 2023.

Në strukturën e shpenzimeve operative të vitit 2024 shpenzimet për udhëtim e dicta përbënin 51,6% të totalit të shpenzimeve operative. Gjatë vitit 2024 ka patur një ulje të shpenzimeve për udhëtime e dieta jashtë vendit, të cilat në strukturë kundrejt totalit Art.602, u ulën në 13,5% nga 27% që ishin në 6-mujorin e II 2023. Ndërsa shpenzimet për udhëtime e dicta brenda vendit, në strukturë kundrejt totalit Art.602, u rritën në 38 % nga 19.6% që ishin në 6-mujorin e II 2023.

Shpenzime për shërbime të tjera për automjetet gjatë vitit 2024 patën një rritje të theksuar krahasuar me periudhat e tjera, duke arritur në nivelin e 13% të totalit të shpenzimeve operative.

Nga grupi i auditimit u morën në shqyrtim 3 praktikë të udhëtimeve e dicta jashtë vendit. Për vitin 2023 u kontrollua praktika e udhëtim në Bremen/Gjermani në korrik 2023. Për vitin 2024 u kontrollua, praktika e udhëtimit me jashtë në Amsterdam shtator 2024, dhe në Angli në muajin dhjetor 2024. Për të tre praktikat rezultoi se ishte marrë miratimi paraprak nga Këshilli i Ministrave, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, si dhe ishte përgatitur Autorizimi nga Titullari, Urdhër – Shërbimi për jashtë vendit, biletat e udhëtimit me avion, taxi, faturët e hotelit për akomodim dhe fjetje etj.

Praktikat e dietave për punonjësit me shërbim jashtë vendit ishin konform VKM-së nr. 870, date 14.02.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", si dhe udhëzimi nr.22 datë 10.07.2013, në zbatim të tij.

Gjithashtu, për periudhën e auditimit, grupi i auditimit mori në shqyrim disa praktika të dietave brenda, për të cilat rezultoi se ishin në përputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar.

Institucioni ka respektuar trajtimin financiar të punonjësve për përballimin e shpenzimeve të shërbimit sipas distancës së shërbimit nga qendra e punës.

Pagesa e dietave është shoqëruar me paraqitjen e faturës elektronike fiskale.

Megjithatë nuk është ruajtur i njëjti standart përsa i përket procedurës së fillimit ku në disa raste shkresa ka emërtimin e lëndës: - Program pune për realizimin e takimeve konsultive me OJF-të... - Autorizim, dhe në disa raste Urdhër. Gjithashtu përshkrimet e mësipërme nuk korrespondojnë në disa raste me përshkrimin e bërë në urdhër shpenzimet e paraqitura për likuidim në degën e thesarit, me fjalën "Urdhër" ndryshe sa është titulluar në shkresë.

Përsa i përket Art.604 "Transferime korrente të brendeshme" ka një realizim pothuajse 100% në çdo vit, gjë që tregon se të pothuajse të gjitha fondet e destinuara për mbështetje për projekte të shoqërisë civile janë shpërndarë plotësisht.

Shpenzimet në Art.606 "Transferata për buxhetet familiare dhe individët" gjatë vitit 2024 ishin në vlerën 60 mijë, ndërsa për periudhën e 7-mujorit 2025 në vlerën 30 mijë lekë.

Nga grupi i auditimit u mor në shqyrtim, për vitin 2024, praktika e dhënies së një ndihme financiare të menjëhershme, në zbatim të VKM-së nr.846 datë 26.12.2024, "Për dhënie të një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore". Institucioni ka dhënë ndihmë të menjëhershme për 4 persona; 2 (dy) punonjës mbështetës të përhershëm, 1 (një) punonjës mbështetës me kontratë dhe 1 (një) specialist me kontratë, në shumën 15 mijë lekë për secilin.

Pagesa është kryer me urdhër shpenzimin nr.457 datë 10.01.2025, kaluar në degën e thesarit Tiranë.

Në vkm-në nr.846 datë 26.12.2024, pika 1 thekson: "Dhënie të një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë lekë), punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme, organikë dhe me kontratë të përkohshme mbi 6-muj, në njësitë e qeverisjes qendrore, të cilët pagohen me sistemin me 9 klasa dhe 13 klasa"

Nga auditimi u konstatua se një punonjës me kontratë të përkohshme, me emërtimin "Specialist" ka marrë ndihmë të menjëhershme financiare në shumën 15.000 lekë, në kundërshtim me pikën 1 të vkm-së, në sipër pusit ai nuk paguhet me sistemin me 9 klasa dhe 13 klasa, por me kategorinë e pagës IV-2. (rek)

Gjithashtu u mor në shqyrtim edhe praktika, kaluar në degën e thesarit me urdhër shpenzimin nr.30 datë 26.02.2025. Praktika përmban urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv me nr.31 datë 21.02.2025 "Për dhënie të ndihmës ekonomike të menjëhershme për rast fatkeqësie", të një punonjësi të institucionit në shumën 30 mijë lekë. Nga Ministria e Financës është bërë detajimi i planit të fondit të veçantë 2025, me shkresën nr.2886/1 datë 17.02.2025, Art.606 në shumën 100 mijë lekë. Rezulton se praktika është e

rregullt dhe në përputhje, me Vendimin nr.929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” të ndryshua, *Shpenzimet për investimet (Art.231)*. gjatë viteve 2023 dhe 2024 kanë rënë krahasuar me periudhat e mëparshme, duke rezultuar me një realizim poshtë nivelin e 50% kundrejt planit të miratuar për investimet. përkatësisht 49% dhe 46%. Gjatë 7-mujorit 2025 nuk ka patur realizimin të investimeve.

• Zbatimi i procedurave të planifikimit dhe kryerjes së prokurimeve publike.

Autoriteti kontraktor ka përgatitur regjistrat e parashikimeve të prokurimeve publike për secilin vit buxhetor 2023-2025, dhe i ka dërguar atë në formë elektronike në APP, dhe me shkresë zyrtare në Degën e Thesarit Tiranë.

Grupi i auditimit konstatoi se regjistrat e parashikimit, për çdo vit periudhë auditimi janë dërguar jashtë afatit përcaktuar në vkm nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nenin 3, pika 3 thekson: “..... Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës”.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në AMSHC për periudhën objekt auditimi, autorizimet për përdorimin e fondeve, sipas nevojave që kanë lindur gjatë kësaj periudhe, janë dhënë nga titullari i institucionit.

Nga auditimi rezultoi se një pjesë e shpenzimeve korente janë realizuar me procedurat e prokurimit me blerje të vogla. Nga auditimi i rasteve të përzgjedhura rezultoi se shumica e blerjeve janë kryer me procedurën elektronike të blerjeve me vlera të vogla (online) në përputhje me ligjit “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij të ndryshuara.

Për 6-mujorin II të vitit 2023, sipas regjistrat të realizimit të prokurimeve publike, dërguar në APP, janë zhvilluar 9 (nëntë) procedura “Blerje me vlera të vogla” në vlerën 1,783 mijë lekë me tvsh, sipas tabelës më poshtë.

Nr.	Procedura e realizuar	Numri i proced	Vlera në 000/lekë		
			Fond limit pa tvsh	Vlerë kontraktuar pa tvsh	me tvsh
1.	Proc.me vlera te vogla gjithsej	9	2,200	1,486	1,783
	prej të cilave:				
	Blerje në formë elektronike	5	1,810	1,220	1,464
	Blerje me proces-Format 5	4	390	266	319
	Blerje per nevoja emergjente	0	0	0	0

Për vitin 2024, sipas regjistrat të realizimit të prokurimeve publike, dërguar në APP, janë zhvilluar 11 procedura “Blerje me vlera të vogla” në vlerën 1,794 mijë lekë me tvsh, sipas tabelës më poshtë.

Nr	Procedura e realizuar	Numri i proced	Vlera në 000/lekë		
			Fond limit pa tvsh	Vlerë kontraktuar pa tvsh	me tvsh

1	Proc.me vlera te vogla gjithsej	11	3,080	1,495	1,794
prej të cilave:					
	Blerje në formë elektronike	6	2,650	1,177	1,412
	Blerje me procesv-Fornat 5	5	430	318	382
	Blerje per nevoja emergjente	0		0	0

Për 7-mujorin e vitit 2025, sipas regjistrimit të realizimit të prokurimeve publike, dërguar në APP, janë zhvilluar 2 procedura "Blerje me vlera të vogla" në vlerën 121 mijë lekë, sipas tabelës më poshtë.

Nr	Procedura e realizuar	Nr. procedurave	Vlera në 000/lekë		
			Fond limit	Vlera kontraktuar	
				pa tvsh	me tvsh
1	Proc.me vlera te vogla gjithsej	2	125	121	121
prej të cilave:					
	Blerje në formë elektronike	0	0	0	0
	Blerje me procesv-Fornat 5	2	125	121	121
	Blerje per nevoja emergjente	0	0	0	0

Grupi i auditimit mori në shqyrtim disa praktika/procedura të prokurimeve me vlerë të vogël për vitet 2023 dhe 2024, sa më poshtë vijon:

- Për vitin 2023 "Blerje pajisje kompjuterike" investim art.231
- Për vitin 2024 "Blerje mobilie për nevojat e Institucionit për sallën e mbledhjeve" investim art.231
- Për vitin 2024 "Blerje e produkteve pastrim/ dezinfektim materiale higjienosanitare" shpenzime operative Art.602
- Për vitin 2024 "Blerje e produkteve kancelarie" shpenzime operative Art.602

Rezultoi se praktika "Blerje pajisje kompjuterike" investim art.231 përmban:

- Kërkesën e AMSHC nr.945 prot, datë 27.10.2023 drejtuar AKSHI-it "Kërkesë për miratimin e specifikimeve teknike për blerjen e pajisjeve hardëare TIK".
- Shkresë e AKSHI-it nr. 6146/1 prot, datë 08.11.2023 "Mbi miratimin e specifikimeve teknike" me fond limit 820,197 lekë.
- Procesverbali nr.1095 datë 19.12.2023 "Mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të pranimit".
- Memo nr.1095/1 datë 19.12.2023 "Kërkesë për blerje të pajisjeve hardëare TIK".
- Urdhër Prokurimi me nr.1095/2 datë 19.12.2023 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: Blerje pajisje kompjuterike".
- Ftesë për ofertë me nr.1095/3 datë 20.12.2023.
- Proceverbali nr.1104 datë 21.12.2023 "I hapjes së procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje pajisje kompjuterike", dhe klasifikimin përfundimtar nga sistemi datë 21.12.2023 me ltuës të parë operatorin "Blue print Technologies" me NIPIT L82428011. me vlerën pa tvsh 410,098.5 lekë.
- Faturën elektronike me nr.192/2023 datë 26.12.2023 rregjistruar në platformën qendrore, nga operatori Blue print Technologies për shumën 410,098 lekë pa tvsh dhe 492,118 me tvsh.

- Procesverbalin e marrjes në dorëzim me nr.1110 datë 26.12.2023
- Fletë hyrjen e magazinës nr.4 datë 26.12.2023.
- Urdhër shpenzimin nr.341 datë 28.12.2023 paraqitur për likuidim në degën e thesarit Tiranë.

Praktika e investimit për vitin 2024 "Blerje mobilie për nevojat e Institucionit për sallën e mbledhjeve" investim art.231 përmban:

- Kërkesë nr.1208 datë 14.11.2024 "Për blerje mobilje për nevojat e institucionit dhe sallën e mbledhjeve"
- Procesverbal nr.1255 datë 11.12.2024 "Për studimin e tregut dhe vendosjen e fondit limit në vlerën 491,798 lekë.
- Urdhër Prokurimi me nr.1255/1 datë 11.12.2024 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: Blerje mobileri për nevojat e Institucionit", me vlerë fondi limit 491,798 lekë pa tvsh.
- Procesverbal nr.1255/2 datë 11.12.2024 "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim"
- Ftesë për ofertë me nr.1255/3 datë 11.12.2024.
- Procesverbal nr.1255/4 datë 12.12.2024 "Për hapjen dhe zhvillimin e blerje me vlerë të vogël -Prokurim me mjete elektronike"
- Procesverbal nr. 1255/5 datë 17.12.2024 për dorëzimin e dokumentacionit nga operatori ekonomik fitues P.F AGURI LLAPUSHI.
- Procesverbal nr.1255/6 datë 17.12.2024 "Për administrimin e mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik P.F AGURI LLAPUSHI.
- Procesverbali nr.1255/7 datë 20.12.2024 "Për shpallje fituesi blerje me vlerë të vogël prokurim me mjete elektronike", të operatori AGURI LLAPUSHI me vlerë pa tvsh 380.000 lekë, i klasifikuar i treti pas tërheqjes së dy operatorëve me vlerë të ofruar më të ulët. Operatorë i klasifikuar i pari, R ÇEKA&CO me NIPT L5352080IJ, është tërhequr nga procedura në datën 13.12.2024. Operatorë i klasifikuar i dyti Bajro Bross me NIPT M113130290, është tërhequr nga procedura në datën 16.12.2024.
- Procesverbal nr.1255/8 prot datë 23.12.2024 për dorëzimin nga operatori ekonomik P.F AGURI LLAPUSHI.
- Faturën elektronike me nr.70/2024 datë 23.12.2024 regjistruar në platformën qendrore, nga Aguri Llapushi për shumën 380.000 lekë pa tvsh dhe 456,000 me tvsh.
- Fletë hyrjen e magazinës nr.4 datë 23.12.2024.
- Urdhër shpenzimin nr.442 datë 16.01.2025 paraqitur për likuidim në degën e thesarit Tiranë.

Praktika "Për blerjen e produkteve pastrim/ dezinfektim materiale higjienosanitare" shpenzime operative Art.602, përmban:

- Kërkesë nr. 998 prot., datë 08.10.2024 "Për blerjen e produkteve pastrim/ dezinfektim materiale higjienosanitare"
- Procesverbal nr. 998/2 prot., datë 08.10.2024 "Për studimin e tregut".
- Urdhër nr.998/1, datë 08.10.2024 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerjen e produkteve pastrim/dezinfektim materiale higjienosanitare", me fond limit 146,607 lekë pa tvsh.
- Procesverbal nr.998/3 prot., datë 08.10.2024 "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim".
- Ftesë për ofertë nr. 998/4 prot, datë 08.10.2024,

- Proçesverbal nr. 998/5 prot., datë 09.10.2024 "Për hapjen dhe zhvillimin e Blerje me Vlerë të Vogël prokurim me mjete elektronike", (shoqëruar me tabelën e listimit të operatorëve ekonomikë ofertues sipas sistemit elektronik të APP-së).
- Proçesverbal nr. 998/6 prot., datë 14.10.2024 "I shpalljes së fituesit", të OE "XH-N-SH Group" sh.p.k, me vlerë 99,880 lekë pa tvsh.
- Proçesverbal nr. 998/7 prot., datë 14.10.2024 "I marrjes në dorëzim të procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje produkte pastrim/dizinfektim materiale higjienosanitare".
- Faturë Elektronike gjeneruar nga platforma qendrore e faturave nr.110/2024 datë 15.10.2024.
- Fletë-hyrje magazine nr.1 datë 15.10.2024.
- Urdhër shpenzim nr. 362, datë 28.10.2024.

Praktika "Për blerje e produkteve kancelar" shpenzime operative Art.602

- Kërkesë nr. 1113 prot., datë 11.11.2024 "Për Blerjen e produkteve kancelarie
- Proçesverbal për studimin e tregut nr. 1113/1 prot., datë 11.11.2024,
- Urdhër nr. 1113/2 prot., datë 11.11.2024 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerjen e produkteve kancelarie", me fond limit 198. 000 lekë.
- Proçesverbal nr.1113/3 prot., datë 11.11.2024 "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim",
- Ftesë për Ofertë nr. 1113/4 , datë 11.11.2024
- Proçesverbal nr. 1113/5 prot., datë 12.11.2024 "Për hapjen dhe zhvillimin e blerje me vlerë të vogël prokurim me mjete elektronike", nga ku u shpall operatori ekonomik me vlerën më të ulët "Jueli" sh.p.k me vlerë të ofertuar 157,000 lekë pa tvsh (shoqëruar nga lista e gjeneruar nga sistemi elektronik i APP-së).
- Proçesverbal nr. 1113/6 prot., datë 13.11.2024 "Për kalim operatori ekonomik i radhës", pas tërheqjes së operatorit ekonomik "Jueli" sh.p.k dhe kalimi tek OE i radhës "Infosoft Office" sh.p.k. i rënditur i dyti me ofertë ekonomike 164. 990 lekë.
- Proçesverbal nr. 1113/7. datë 14.11.2024 "Për dorëzimin e dokumentacionit nga OE fitues "INFOSOFT OFFICE" sh.p.k".
- Proçesverbal nr. 1113/8 prot., datë 14.11.2024 "Për administrimin e mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik "Infosoft Office" sh.p.k.
- Proçesverbal nr. 1148 prot., datë 18.11.2024 "I marrjes në dorëzim të procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje produkte kancelarie".
- Faturë elektronike gjeneruar nga platforma qendrore e faturave me nr. 19205/2024, datë 11.12.2024 me vlerë 164,990 lekë pa tvsh.
- Fletë-hyrje magazinë nr.3 datë 12.12.2024.
- Urdhër shpenzimi nr.420 , datë 17.12.2024.

Nga grupi i auditimit, u konstatua se për të katër praktikat e mësipërme janë ndjekur procedurat e rregullta dhe janë në përputhje me ligjin nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, vkm-në nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, si

dhe Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, të ndryshuar.

Gjithashtu u konstatua se blerjet e vogla si për shpenzimet operative Art 602 ashtu edhe ato për investime Art.231 janë kryer gjatë 6-mujorit të dytë të çdo viti duke krijuar një tryzni dhe vështrësi në menaxhimin e likuidimit të tyre në thesar në ditët e fundit të vitit.

Mallrat dhe shërbimet e blera, janë dokumentuar dhe regjistruar në kontabilitet në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Marrja në dorëzim e tyre është bërë nga komisioni i posaçëm dhe është dokumentuar shpenzimi sipas rregullave në fuqi.

- Zbatimi i rregullave në mbajtjen e kontabilitetit, inventarizimin, përgatitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare.

Për periudhën objekt auditimi për evidentimin e aktiveve, si dhe për administrimin e qarkullimit të tyre, sektori i financës ka mbajtur kartelat e artikujve të inventarit, dokumantacionin e hyrje daljeve në magazinë dhe librat e kontabilitetit për evidentimin e lëvizjes së aseteve. Këto në përputhje me aktet ligjore në fuqi si ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuash, ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Drejtorit Ekzekutiv, ka nxjerrë urdhrin nr.1110, prot., datë 26.12.2023, "Për inventarizimin e gjendjes së magazinës si dhe të Aktiveve të Njësisë", është ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve, konform pikës 81 e 82 "Përgjegjësitë për Inventarizimin", për vitin 2023.

Gjithashtu për vitin 2024, Drejtori Ekzekutiv ka nxjerrë urdhrin nr.1394 datë 31.12.2024, "Ngritjen e Komisionit për inventarizimin e gjendjes së magazinës në datën 31 dhjetor si dhe për përditësimin e kartelave të stafit".

Nga komisioni është mbajtur procesverbali ku janë pasqyruar listat e inventarizimit. Llogaritë e inventarit janë të rakorduara me gjendjet në bilanc. Llogaritë e debitorëve dhe kreditorëve janë të mbajtura në mënyrë analitike dhe rakordojnë me gjendjen e tyre në bilanc. Është kryer inventari fizik i aseteve dhe ndryshimet në gjendjet e tyre janë pasqyruar në fund të vitit.

Inventarizimi i mallrave dhe aseteve për vitet 2023 dhe 2024 është bërë në përputhje me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 i ndryshuar.

Për periudhën e auditimit u morën në shqyrtim edhe 2 praktika për vlerësimin e aktiveve të njësisë me qëllim nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre. Praktika e parë është ajo e procesuar fillimisht me urdhrin nr.917 datë 16.10.2023 dhe dyta procesuar me urdhrin nr.208 prot, datë 21.03.2025. Të dy praktikat janë zbatuar në përputhje me udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Megjithatë në vijim të udhëzimit të mësipërm, paragrafi "Procesverbali për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve", pika 110 thekson: "Hartohet nga komisioni për nxjerrjen nga përdorimi në tri kopje, ku përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre. ose nxjerrjen

	<i>jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve, dhe nënshtrohet nga të gjithë anëtarët e komisionit</i> Proceverbali përfundimtar nuk tregon mënyrën se si është bërë faktikisht nxjerrja jashtë përdorimit, vendi dhe koha ku është bërë dhe destinacioni përfundimtar i aktive. Gjithashtu, ka foto që evidentojnë pikërisht kryerjen e plotë të procedurës vetëm për vitin 2023. Ndërsa për vitin 2025 nuk ka foto. Institucioni që prej fillimit të tij ka përdor Sistemin Alfa Buxhetor për menaxhimin e financave buxhetore dhe lëvizjet kontabile sipas planit të llogarive dhe legjislacionit për institucionet buxhetore në Shqipëri, duke mbuluar procedurat për urdhërpagesa, marrëdhëniet me thesarin, dhe lëvizjet të mallrave në dhe nga magazinave. Institucioni ka përgatitur bilanci kontabël për vitet 2023 dhe 2024. Ato janë dërguar në degën e thesarit Tiranë brenda afatit të përcaktuar nga ligji (brenda datës 31 mars), përkatësisht me shkresën nr. 246 datë 25.03.2024 (bilanci për vitin 2023) dhe shkresën nr.205 datë 21.03.2025 (bilanci për vitin 2024). Veprimet kontabile janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumentave justifikuese dhe janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Janë përgatitur bilanci vjetore dhe së bashku me pasqyrat financiare janë dërguar në degën e thesarit brenda afatit të përcaktuar. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive me bilanci e viteve 2023 dhe 2024, rezultoi se aktivi është i barabartë me pasivin dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Kontabiliteti në institucion mbahet në mënyrë të informatizuar dhe sipas kërkesave të Udhëzimit përkatës "Për mbylljen e llogarive vjetore në institucionet buxhetore", Sa trajtuam më lart arrijmë në konkluzion se janë respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi në mbajtjen e kontabilitetit, inventarizimin e pasurisë si dhe në përgatitjen e miratimin e pasqyrave financiare.
BAZA RREGULLATORE	- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 "Për Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" pika 188, i ndryshuar;
PROBLEMATIKA E KONSTATUAR	Nga verifikimi i Akt-Rakordimeve me Degën e Thesarit përsa i përket shpenzimeve për periudhën e auditimit, u konstatuan gabime në plotësimin e tyre për periudhën dhjetor 2023, dhjetor 2024 dhe 7 muajor 2025
EVIDENCA GJFTJEVE	Akt Rakordimet e dhjetor 2023; dhjetor 2024 dhe 7 muajor 2025 Referenca faqe 22 në projekt
IMPAKTI I GJETJES	Mos rakordimet e sakta sjellin deformim ose pasaktësi të shifrave të cilat çojnë në gjykim të gabuar të performancës financiare të institucionit dhe pasqyrimet në bilanc.
RENDËSI RISKU	I mesëm
REKOMANDIMI 2	Sektori i financës të ribartojë akt rakordimet e sakta (të mbylljes së vitit) për shpenzimet në muajin dhjetor të vitit 2023 dhe 2024 dhe në vazhdimësi për vitin 2025.

Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit pas observacionit	Është pramur.
BAZA RREGULLATORE	- VKM nr.717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore", të ndryshuar. VKM nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike".
PROBLEMATIKA E KONSTATUAR	Institucioni nuk ka reflektuar ndryshimet në pagë, sipas vkm nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike". Pika 9 e vkm-së ka ndryshuar nivelin e shtesës për pagesë për çdo nivel shkalle vështirësie. Grupi i auditimit konstatoi se, shuma e shtesës mbi pagë për vështirësi në punë dhe dëmshmëri në shëndet, që i takon magazinierit duhet të ishte 6,000 dhe jo 5,330 lekë.
EVIDENCA E GJETJES	VKM nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike". Pika 9 e vkm-së ka ndryshuar nivelin e shtesës për pagesë për çdo nivel shkalle vështirësie. "Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesë mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, si më poshtë vijon: a) Në shkallën e parë, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj; b) Në shkallën e dytë, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj"; Pika 15 thekson se "Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për këtë vit". Urdher shpenzimi nr. Referenca faqe 24 ne raport
IMPAKTI I GJETJES	Ndikon në pagën që institucioni duhet ti japë magazinierit si punonjës mbështetës.
RRENDËSI RISKU	I mesëm
REKOMANDIMI 3	Spektori i financës të përllogarisë pagën dhe diferencën e vështirësisë që përfiton punonjësi i magazinës në zbatim të vkm 326/2023.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit pas observacionit	Është pramur.
BAZA RREGULLATORE	- VKM nr.717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore", të ndryshuar. - VKM nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike".

BAZA RREGULLATORE	Vendimit nr.846 datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore". pika 1
PROBLEMATIKA E KONSTATUAR	Institucioni ka dhënë ndihmë të menjëhershme për 4 persona; 2 (dy) punonjës mbështetës të përhershëm, 1 (një) punonjës mbështetës me kontratë dhe 1 (një) specialist me kontratë, në shumën 15 mijë lekë për secilin. <i>Nga auditimi u konstatua se një punonjës me kontratë të përkohshme, me emërtimin "Specialist" ka marrë ndihmë të menjëhershme financiare në shumën 15,000 lekë, në kundërshtim me pikën 1 të vkm-së, me sipër pasi ai nuk paguhet me sistemin me 9 klasa dhe 13 klava, por me kategorinë e pagës IV-2.</i>
EVIDENCA GJETJES	L vkm-në nr.846 datë 26.12.2024, Urdher shpenzimi nr. 457 datë 10.01.2025 Referenca faqe 27
IMPAKTI I GJETJES	Ndikon në shpenzimet korrente të institucionit
RËNDËSI RISKU	I lartë
REKOMANDIMI 4	Të mbahet nga paga shuma prej 15,000 lekësh, e përfshuar padrejtësisht nga punonjësi me kontratë me emërtimin "specialist"
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit pas observacionit	Është pranuar.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE NGA AUDITIMI I MËPARSHËM.

a) Hartimi dhe miratimi i planit të masave për realizimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Me shkresë nr. 14430/4 datë 15.09.2023, nga drejtoria e Auditimit në MFE, subjektit i është dërguar raporti përfundimtar i auditimit të mëparshëm dhe plani i veprimeve me rekomandimet e sugjeruara.

Bazuar në nenin 12, gërma d, të Ligjit 114 datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", pikës 3 të Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 13.02.2017 "Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm", subjekti i audituar ka hartuar dhe miratuar planin e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 873 datë 19.09.2023.

b) Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna dhe i dokumentimit të procesit për çdo rekomandim.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi:

a) Vlerësimi i rezultateve nga zbatimi i rekomandimeve

Nga shqyrtimi i rezultateve për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezultoi se nga 5 rekomandimet e lëna janë realizuar plotësisht 4 rekomandime dhe është në proces 1 rekomandim.

Statusi i realizimit të rekomandimeve:

1. AMSHC dhe Bordi Mbikëqyrës të bëjnë harmonizimin e akteve në fuqi që rregullojnë funksionimin e institucionit dhe marrëdhëniet e punës së stafit me qëllim saktësimin se cilat akte ligjore e nënligjore duhet të zbatohet agjensia.
Rekomandimi është në proces: Institucioni është në fazën e hartimit të draftit.
2. AMSHC të bëjë pjesë të raportit vjetor rezultatet që lidhen me veprimtarinë e Bordit Mbikëqyrës në fushën e shqyrtimit, miratimit dhe skualifikimit të projekt-propozimeve të organizatave konkurruese.
Rekomandimi është realizuar: Në raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit janë pasqyruar veprimtaria e bordit sa kërkuar në rekomandim.
3. AMSHC dhe Bordi mbikëqyrës të miratojnë rregullat për mënyrën e ndërtimit të raportit vjetor të institucionit (strukturën e raportit), aktivitetet që do të përfshihen në raportim për secilin sektor, afatin e hartimit/raportimit dhe afatet e dërgimit të autoritetet sipas përcaktimit ligjor.
Rekomandimi është realizuar: Me vendim bordi është miratuar urdhëri nr. 1113 datë 29.12.2023, për miratimin e strukturës së ndërtimit të raportit vjetor të veprimtarisë së institucionit.
4. AMSHC, në relacionin shpjegues dhe në tabelën përmbledhese të shqyrtimit dhe vlerësimit të projekt-propozimeve që i paraqiten Bordit Mbikëqyrës, për vlerësimin dhe miratimin e organizatës fituese të përshkruajë në mënyrë të detajuar shkaqet për secilin kandidat të skualifikuar.
Rekomandimi është realizuar. (në relacion janë bërë reflektimet)
5. AMSHC, të inicioi në Bordin Mbikëqyrës për ndryshime në nenin 16 të rregullores "Mbi Procedurat e financimit me grante në mbështetje të shoqërisë civile", për përditësimin e skemës së financimit të organizatave përfituese të granteve.
Rekomandimi është realizuar. (me Vendimin e BM nr. 01, datë 19.02.2024 është bërë ndryshimi në rregullore)

Grupi i auditimit, falenderon me këtë rast, stafin e institucionit për bashkëpunimin në realizimin e këtij auditimi.

Bazuar në nenin 12. gërma d, të Ligjit 114 datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", AMSHC, brenda 30 ditësh, duhet të hartojë dhe miratojë planin e veprimit në zbatim të rekomandimeve dhe të njoftojë Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

AUDITUESIT

Rregjina MIKELI

Agim PASKALI




PLAN VEPRIMI

PËR REKOMANDIMET E SYGJERUARA NË RAPORTIN PERQUNDIMTARE TË AUDITIMIT
SUBJEKTI: AMSHC

Nr.	REKOMANDIME	Renditja sipas nivelit të riskut	Referenca e paragraf në raport	Reagimi i menaxhimit	Afati i përcaktuar	Personat e ngarkuar për të ndjekur realizimin e rekomandimeve
1	Ajencia për mbështetjen e shoqërisë civile të vijojë procedurat për plotësimin e bordit me anëtarë të rinj deri në emërimin e tyre.	I mesëm	Faqe 19	Pranuar	Menjehere/in e vazhdimesi	
2	Sektori i financës të ribartojë akti raktordimet për mbledhjen e vitit për shpenzimet për vitet 2023 dhe 2024 dhe në vazhdimësi për vitin 2025.	I mesëm	Faqe 33	Pranuar	Menjehere/in e vazhdimesi	
3	Të mbahet nga paga shuma prej 15,000 lekësh, e perfutuar padrejtësisht nga punonjësi me kontratë me emërtimin "specialist"	I lartë	Faqe 34	Pranuar	Menjehere/in e vazhdimesi	
4	Sektori i financës të përfillojë pagën dhe diferencën e vëzhgësive që perfiton punonjësi i magazinës në zbatim të vkm 326/2023.	I mesëm	Faqe 34	pranuar		

PËR AMSHC

AUDITUESIT

DREJTORI EKZEKUTIV

Rregjina MIKELI

Agim PASKALI



Handwritten signature of Rregjina Mikeli

Handwritten signature of Agim Paskali